



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 122

Tiranë – E martë, 3 gusht 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 100/2021, datë 7.7.2021	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) e Departamentit Federal Zviceran për Punët e Jashtme, e cila vepron përmes Ambasadës Zvicerane në Shqipëri për projektin “Lëviz Albania”, faza e dytë korrik 2019–qershor 2023”.....
	12629
Dekret i Presidentit nr. 13171, datë 26.7.2021	Për shpallje ligji.....
	12636
Vendim i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare nr. 125, datë 28.7.2021	Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e rregullave dhe metodologjisë së llogaritjes së dëmshpërblimit që mbulohet nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”.....
	12636

**LIGJ**
Nr. 100/2021**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE KONFEDERATËS
ZVICERANE, PËRFAQËSUAR NGA
AGJENCIA ZVICERANE PËR ZHVILLIM
DHE BASHKËPUNIM (SDC) E
DEPARTAMENTIT FEDERAL
ZVICERAN PËR PUNËT E JASHTME, E
CILA VEPRON PËRMES AMBASADËS
ZVICERANE NË SHQIPËRI PËR
PROJEKTIN “LËVIZ ALBANIA”, FAZA E
DYTË KORRIK 2019–QERSHOR 2023”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**VENDOSI:****Neni 1**

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) e Departamentit Federal Zviceran për Punët e Jashtme, e cila vepron përmes Ambasadës Zvicerane në Shqipëri për projektin “Lëviz Albania”, faza e dytë korrik 2019–qershor 2023”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 7.7.2021

Shpallur me dekreten nr. 13171, datë 26.7.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
KONFEDERATËS ZVICERANE,
PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA
ZVICERANE PËR ZHVILLIM DHE
BASHKËPUNIM (SDC) E DEPARTAMENTIT
FEDERAL ZVICERAN PËR PUNËT E
JASHTME, E CILA VEPRON PËRMES
AMBASADËS ZVICERANE NË SHQIPËRI
PËR PROJEKTIN “LËVIZ ALBANIA”, FAZA
E DYTË KORRIK 2019–QERSHOR 2023

Një projekt dypalësh bashkëpunimi dhe zhvillimi;

Në përpjekje për të forcuar marrëdhëniet miqësore që ekzistojnë mes dy vendeve;

Në përputhje dhe në zbatim të Marrëveshjes Kuadër lidhur me Bashkëpunimin Teknik e Financiar dhe Ndihmën Humanitare, lidhur mes Këshillit Federal Zviceran dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, më 11 maj 2007 dhe ratifikuar më 13 shtator 2007 nga Parlamenti i Shqipërisë si ligji nr. 9801;

Në respekt të parimeve demokratike dhe të drejtave themelore të njeriut të parashikuara në veçanti në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, mbi të cilat janë bazuar politikat e brendshme dhe të jashtme të të dyja Palëve dhe përbëjnë një element thelbësor në një bazë të barabartë me objektivat e Marrëveshjes aktuale;

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Konfederata Zvicerane kanë rënë dakord mbi kushtet dhe afatet e parashikuara më poshtë:

Neni 1**Kushte të përgjithshme dhe përkufizime**

Kudo ku përdoren në këtë Marrëveshje, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga konteksti, termat e paraqitura më poshtë do të kenë kuptimet përkatëse:

a) “Palët” nënkupton Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatën Zvicerane;

b) “Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë” nënkupton Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Brendshme;



c) “Konfederata Zvicerane” përfaqësohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) e Departamentit Federal Zviceran për Punët e Jashtme;

d) “Projekti” nënkupton projektin “Lëviz Albania”;

e) “SDC” nënkupton Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim të Departamentit Federal Zviceran për Punët e Jashtme;

f) “Grant” nënkupton kontributin e dhënë nga Konfederata Zvicerane, në përputhje me këtë Marrëveshje;

g) “Partneri zbatues” nënkupton fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA);

h) “Nënpërfituesi” nënkupton partnerin që përdor grantin e dhënë nga projekti “Lëviz Albania”, përmes thirrjes për propozime.

Neni 2

Përgjegjësia e zbatimit

Autoritetet e mëposhtme do të jenë përgjegjëse për zbatimin e Marrëveshjes:

Për Konfederatën Zvicerane:

Agjencia Zvicerane për Zhvillim e Bashkëpunim (SDC) përfaqësohet nga Ambasada e Zvicrës në Shqipëri.

Për Këshillin e Ministrave të Shqipërisë:

Ministria e Brendshme

Ministria e Brendshme do të jetë homologu qeveritar i Projektit.

Partneri zbatues:

SDC-ja do t'i besojë fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA) zbatimin e Projektit.

Neni 3

Qëllimet dhe objektivat

Objektivi i Projektit është: Popullsia e Shqipërisë do të përfitojë nga përmirësimi i demokracisë në shkallë vendore.

Rezultatet specifike të këtij Projekti janë si më poshtë:

Rezultati 1: Aktorët e shoqërisë civile do të ndikojnë në përcaktimin e përparësive vendore, vendimarrjen dhe efektivitetin e ofrimit të shërbimeve nga autoritetet vendore.

Rezultati 2: Aktorët e shoqërisë civile përfshihen në veprime strategjike/të përbashkëta

për të adresuar sfidat strukturore/sistematike që lidhen me qeverisjen e mirë në nivelin lokal.

Për të arritur këta objektiva, Projekti do të bashkëpunojë me institucionet e mëposhtme:

Qytetarët, organizatat e shoqërisë civile, median, njësitë e pushtetit vendor, institucionin e prefektit, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Zyrën e zëvendëskryeministrit, Ministrinë e Financave.

Ndërhyrjet kryesore, aktivitetet dhe rezultatet e parashikuara janë specifikuar në një përmbledhje të dokumentit të Projektit, bashkëlidhur kësaj marrëveshjeje. Dokumenti i Projektit për fazën 2 përfshin periudhën 1 korrik 2019–30 qershor 2023.

Neni 4

Detyrimet e Palëve

Detyrimet specifike të Konfederatës Zvicerane përfshijnë sa më poshtë:

a) Deri në 30 qershor 2023, Konfederata Zvicerane synon të vendosë në dispozicion fonde në formën e një granti të pakthyeshem deri në një shumë maksimale prej 6'900'000 CHF (gjashtë milion e nëntëqind mijë franga zvicerane) që do të përdoren ekskluzivisht për zbatimin e projektit, sipas qëllimeve dhe objektivave të përcaktuar në nenin 3;

b) Ky grant nuk mund të ndahet apo përdoret për qëllime të tjera. Pjesët e pashfrytëzuara të grantit që mbeten në fund të projektit do t'i kthehen sërish konfederatës Zvicerane;

c) Konfederata Zvicerane përmes SDC-së ka kontraktuar si partner zbatues Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA);

d) Granti do të shpërndahet dhe kontrollohet sipas parashikimeve të kontratës së lidhur ndërmjet SDC-së dhe OSFA-së.

Detyrimet specifike të Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë përfshijnë:

a) Do të veprojë si bashkëpërgjegjëse për strategjinë e projektit;

b) Siguron lidhjen e projektit “Lëviz Albania” me politikat kombëtare dhe kornizën ligjore përkatëse për shoqërinë civile, në mënyrë që të mundësojë dhe të promovojë përputhjen e objektivave të “Lëviz Albania” me kushtet e kornizës kombëtare;

c) Mbështet lehtësimin, shpërndarjen e përvojave dhe informacionit bazuar në rezultatet e



arritura dhe ndikimet që ka ky projekt në nivel kombëtar;

d) Mbështet dhe lehtëson lidhjen dhe bashkëpunimin me ministritë e institucionet e tjera, prefektët e qarqeve, NJV-të;

e) Siguron përgjegjshmërinë dhe bashkëpunimin e strukturave të dekoncentruar në nivelin rajonal dhe/ose lokal;

f) Bën të mundur alokimin e nevojshëm të buxhetit për kthimin e taksës së vlerës së shtuar (TVSH) në Projekt për një shumë maksimale prej 210,000 CHF (dyqind e dhjetë mijë franga zvicerane), deri në fund të muajit shtator 2023.

g) Këshilli i Ministrave i përjashton ekspertët e huaj të angazhuar në bazë të kësaj marrëveshjeje, si dhe familjarët e tyre nga të gjitha taksat gjatë periudhës së vlefshmërisë së kësaj Marrëveshjeje, sipas nenit 4.1 pika c e Marrëveshjes së lidhur midis Këshillit Federal Zviceran dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, për bashkëpunimin teknik dhe financiar dhe ndihmën humanitare.

Neni 5

Menaxhimi i Projektit

a) Projekti është një ndërmarrje e përbashkët midis Ministrisë së Brendshme dhe SDC-së, e cila vepron përmes Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri;

b) Konfederata Zvicerane ia ka besuar këtë projekt fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA), si agjencia zbatuese e projektit, sipas një kontrate të nënshkruar midis Qeverisë së Konfederatës Zvicerane dhe OSFA. Kjo agjenci zbatuese merr përsipër në emër të Qeverisë së Konfederatës Zvicerane të gjitha detyrat operationale, administrative dhe mbikëqyrëse të projektit, përfshirë disbursimet, monitorimin dhe raportimin;

c) SDC-ja mund të mandatojë ekspertë të huaj dhe vendorë afatgjatë e afatshkurtër për të mbështetur zbatimin e projektit;

d) SDC-ja mund të mandatojë individë të tjerë dhe organizata vendore ose ndërkombëtare për zbatimin e pjesëve specifike të projektit, si për shembull, për rishikimin afatmesëm dhe vlerësimin për përfundimin e projektit;

e) Ministria e Brendshme ndërmerr veprimet e nevojshme për të lehtësuar zbatimin e aktiviteteve të projektit të rëna dakord; ofron mundësinë për

përdorimin e informacionit përkatës, përfshirë të dhënat statistikore që konsiderohen të nevojshme dhe të dobishme për përmbushjen e objektivave të projektit.

Neni 6

Mbikëqyrja dhe koordinimi

Për të siguruar mbikëqyrjen e përgjithshme, cilësinë, rëndësinë dhe koordinimin e projektit, si dhe për të adresuar çështjet e politikave, do të krijohet një Bord Këshillues (BK) i cili do të mbledhet një herë në vit. BK-ja do të arrijë në kuorum vetëm kur janë të pranishëm përfaqësuesit e dy Palëve. Vendimet merren me konsensusin e të gjithë anëtarëve të pranishëm me të drejtë vote. Në rastet kur nuk mund të arrihet konsensus, do të fillojë një proces negociues. SDC-ja rezervon të drejtën e vendimit përfundimtar.

BK-ja do të përbëhet nga anëtarët e institucioneve të mëposhtme, ku secili do të ketë të drejtë e një vote:

- Një përfaqësues i Ambasadës Zvicerane;

- Një përfaqësues i Ministrisë së Brendshme (në rast të ndryshimeve dhe riorganizimeve të qeverisë, do të jetë ministria përgjegjëse për qeverisjen vendore);

- Dy ekspertë të shquar për demokracinë vendore, shoqërinë civile ose median.

Projekti “Lëviz Albania” do të luajë rolin e sekretariatit të Bordit Këshillues. Drejtuesi i Ekipit të “Lëviz Albania” merr pjesë në mbledhje pa të drejtë vote.

BK do të kryejë detyrat e mëposhtme:

- Do të ofrojë këshilla, udhëzime dhe rekomandime strategjike, teknike dhe operationale për ekipin e projektit, në lidhje me fushat e ndërhyrjes së “Lëviz Albania”, qasjet metodologjike dhe instrumentet e projektit;

- Do të këshillojë ekipin e projektit për objektivat tematikë dhe gjeografikë ose objektivat për shpërndarjen e instrumenteve të projektit të tij;

- Do të shqyrtojë dhe komentojë mbi dokumentet strategjike, raportet vjetore dhe planin vjetor të funksionimit dhe do të japë rekomandime për përmirësime të mëtejshme.

Me kërkesë të një prej anëtarëve të BK-së, mund të thërritet një mbledhje e paplanifikuar. Mbledhjet drejtohen bashkërisht nga Palët.



Palët do të informojnë menjëherë njëri-tjetrin dhe, në masën e arsyeshme, do të konsultohen me njëri-tjetrin për çdo ngjarje, e cila pengon ose rrezikon të pengojë zbatimin e suksesshëm të projektit.

Neni 7

Prokurimi i mallrave e i shërbimeve

a) Mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga të ardhurat e kontributit zviceran do të sigurohen në përputhje me ligjin zviceran të prokurimeve.

b) Gjatë kohëzgjatjes së Projektit, mallrat e siguruar përmes fondeve të SDC-së, të cilat do të përdoren në Projekt, do të mbeten në dispozicion të pakufizuar të Projektit dhe nuk do të devijohen nga qëllimi i Projektit, pa marrë miratimin paraprak me shkrim të SDC-së;

c) Nëse për ndonjë arsye Projekti duhet të ndërpritet, Palët do të marrin një vendim me shkrim, lidhur me përdorimin e mallrave të siguruar me kontributin zviceran. Në këtë rast, SDC-ja nuk mban asnjë lloj përgjegjësie në lidhje me mallrat e përmendura;

d) Në përfundim të Projektit, SDC-ja do të marrë një vendim për pronën dhe përdorimin e mallrave të blera gjatë kohës së zbatimit të projektit.

Neni 8

Pezullimi dhe zgjidhja e Marrëveshjes

a) Secila Palë do të ketë të drejtë ta ndërpresë këtë Marrëveshje, duke njoftuar me shkrim gjashtë muaj më parë lidhur me zgjidhjen e marrëveshjes.

b) Në rast se secila Palë mendon se qëllimet e kësaj Marrëveshjeje nuk mund të arrihen më ose se Pala e dytë nuk po i përmbush detyrimet e saj, Pala tjetër do të ketë të drejtë ta pezullojë ose ta zgjidhë këtë Marrëveshje, duke njoftuar me shkrim tre muaj përpara. Pavarësisht nga është thënë më sipër, secila Palë mund ta zgjidhë Marrëveshjen aktuale me efekt të menjëhershëm, në rast se konstaton shkelje të konsiderueshme të saj. Shkelje të konsiderueshme do të nënkuptojë shkelje serioze të një prej objektivave thelbësorë të kësaj Marrëveshjeje.

c) Në rast se ngjarjet që vijnë si rezultat i forcave madhore (fatkeqësi natyrore etj.) parandalojnë

zbatimin e Marrëveshjes, secila Palë mund ta zgjidhë Marrëveshjen në fuqi që nga momenti kur zbatimi i saj bëhet i pamundur.

e) Në rast të zgjidhjes së parakohshme të kësaj Marrëveshjeje ose në përfundim të projektit, të gjitha fondet që nuk janë shpenzuar dhe që janë siguruar në kuadër të projektit, do t'i kthehen mbrapsht SDC-së.

Neni 9

Ndryshimet dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Të gjitha modifikimet ose ndryshimet në këtë Marrëveshje do të bëhen me shkrim me pëlqimin e të dyja Palëve. Mosmarrëveshjet në lidhje me interpretimin ose zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhen me bisedime diplomatike midis Palëve.

Neni 10

Dispozita të përgjithshme

Brenda kuadrit të kësaj marrëveshjeje, Palët nuk do të propozojnë drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë përfitime të çfarëdo natyre. Ata nuk do të pranojnë asnjë propozim të tillë. Çdo sjellje e korruptuar ose e paligjshme (p.sh. oferta, dhurata, pagesa, shpërblime ose çdo përfitim tjetër) nënkupton një shkelje të kësaj marrëveshjeje dhe justifikon zgjidhjen e saj, si dhe/ose përdorimin e masave korrigjuese plotësuese, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 11

Aneksat

Një përmbledhje e dokumentit të projektit (aneksi 1) përbën një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12

Kohëzgjatja dhe efektshmëria

Kjo Marrëveshje mbulon periudhën nga 1 korriku 2019 deri më 30 qershor 2023. Ajo do të hyjë në fuqi me njoftimin e fundit mes palëve, për përfundimin e procedurave të brendshme ligjore.

Kjo Marrëveshje është shkruar në dy origjinale, në gjuhën shqipe dhe angleze. Të dyja versionet e



teksteve janë autentike dhe kanë të njëjtën vlerë. Në rast se ekzistojnë ndryshime në interpretim, versioni në gjuhën angleze do të mbizotërojë.

Palët në këtë Marrëveshje konfirmojnë dhe e nënshkruajnë këtë Marrëveshje të lidhur në Tiranë, më ____.

Në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane.

**Për Këshillin e Ministrave të Republikës
së Shqipërisë**

Znj. Romina Kuko
Zëvendësministër
Ministria e Brendshme
Data e nënshkrimit

Për Konfederatën e Zvicrës

21.5.2021
Z. Patrik Meier
Zëvendëseshëf i Misionit
Ambasada e Zvicrës në Shqipëri
Data e nënshkrimit

**ANEKSI 1
I
MARRËVESHJES**

Ky Aneks përbën një pjesë integrale të Marrëveshjes.

Emri i projektit	LevizAlbania		
Vendi, vendndodhja kryesore	Shqipëri, mbulim i gjerë i të gjitha bashkive në mbarë vendin, zyra e projektit në Tiranë		
Fusha e veprimit	Qeverisja Demokratike	Fusha e punës	Qeverisja Vendore
Data e fillimit	01.07.2019	Data e përfundimit	30.06.2023
Faza	Faza II		
Përshkrim shkurtër	Gjatë Fazës I, LevizAlbania kontribuoi në arritjen e rezultateve të prekshme drejt përmirësimit të demokracisë vendore, nëpërmjet granteve për Organizatat Jofitimprurëse (OJF-të), grupet joformale dhe qytetarët, në mbështetje të kërkesës së tyre për qeverisje vendore transparente dhe llogaridhënëse, si dhe për shërbime publike efikase. LevizAlbania do të vijojë të mbështesë aktorët e shoqërisë civile në mbarë vendin, duke përfshirë gratë dhe të rinjtë, nëpërmjet qasjes nga poshtë-lart. Projekti do të mbështesë krijimin e koalicionëve për t'i dhënë shtysë ndryshimit strukturor dhe sistematik në nivel vendor dhe kombëtar, si dhe promovimit të praktikave të mira në mbështetje të demokracisë vendore. Projekti e konsideron median si mjet advokimi për t'iu dhënë zë kërkesave të palëve të interesit. Sinergjitë me projekte të tjera të SDC-së dhe donatorë të tjerë do të maksimizojnë rezultatet e mbështetjes së ofruar për qeverisjen e mirë në Shqipëri në nivel vendor.		



Qëllimi përgjithshëm	Popullsia shqiptare përfiton nga demokracia e përmirësuar në nivel vendor.
Objektivat specifike/ Rezultatet	1. Aktorët e shoqërisë civile ndikojnë në përcaktimin e përparësive vendore, vendimarrjen dhe efikasitetin e ofrimit të shërbimeve nga autoritetet vendore; 2. Aktorët e shoqërisë civile marrin përsipër dhe angazhohen në veprime strategjike/të përbashkëta, për të mbikëqyrur dhe adresuar sfidat strukturore të lidhura me qeverisjen e mirë në nivel vendor.
Produktet	1.1 Ndërhyrjet (grantet) me bazë kërkesë, që ofrohen në mënyrë transparente, konkurruese dhe të paanshme, zbatohen me sukses në mbarë vendin nëpërmjet aktorëve vendas të shoqërisë civile. 1.2 OJF-të dhe aktivistët e mbështetur përdorin median dhe bashkëpunojnë me gazetarët për të advokuar lidhur me demokracinë e përmirësuar vendore. 1.3 Aktivizmi i të rinjve mbështetet nëpërmjet marrëdhënieve të konsoliduara të të rinjve me komunitetet vendore, për të përmirësuar qeverisjen vendore dhe për të ndikuar në vendimarrje. 1.4 Publikimi i raporteve të monitorimit të bazuar në evidenca dhe i instrumenteve të matjes së perceptimeve të qytetarëve mbi qeverisjen e NJQV-ve dhe ofrimit të shërbimeve. 1.5 Qendrat ligjore vendase ofrojnë mbështetje ligjore për t'iu mundësuar aktorëve të shoqërisë civile të ndërmarrin veprime ligjore për përmirësimin e qeverisjes vendore në fushat e kujdesit shëndetësor parësor, mjedisit, mbrojtjes së konsumatorit, si dhe ofrimit të shërbimeve në nivel vendor dhe rajonal. 1.6 Shtimi i mundësive për shkëmbime, rrjetëzim dhe këshillim për aktorët e shoqërisë civile (OJF dhe individë), me qëllim influencimin e politikave dhe vendimarrjes vendore. 1.7 Përditësimi, aksesimi dhe përdorimi i vazhdueshëm i platformës së të dhënave të hapura, për të matur performancën fiskale dhe financiare të qeverive vendore, nga palët e interesuara. 1.8 Përditësimi, aksesimi dhe përdorimi i vazhdueshëm i platformës multifunksionale nga qytetarët, e cila promovon përmbajtjen mediatike të pavarur dhe cilësore.
Përfituesit	OJF, grupe joformale dhe qytetarë aktivë në të 61 bashkitë
Konsorciumi	OSFA, Partnerët Shqipëri, Co-Plan
Donatori	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
Burimet	6.9 milionë CHF

Përmbledhje ekzekutive

Deficiti i demokracisë në Shqipëri mbetet në nivele të larta dhe asnjë forcë e jashtme nuk mund ta zëvendësojë rolin e rëndësishëm të proceseve të brendshme të nxitura nga aktorët vendës. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në nivelin e qeverisjes vendore dhe për rolin vendimtar që duhet të luajë shoqëria civile, qytetarët dhe aktorët e tjerë për të vijuar presionin mbi institucionet vendore dhe, për të nxitur procese që synojnë të sjellin transformim real, duke përmbushur pritshmëritë më të mëdha të individëve. Megjithatë, vetëm aktivizmi nuk është zgjidhja magjike e problemeve. Konkretisht, shoqëria civile duhet të ushtrojë presion mbi çështje me interes për njerëzit, duke konsoliduar në këtë mënyrë bazën e saj të mbështetjes dhe legjitimitetit, dhe duke ndryshuar dinamikën e pushtetit përballë qeverisjes vendore dhe elitave politike. Debatet politike vijnë të pengojnë bashkëpunimin efikas dhe kuptimplotë midis përkrahësve, pasi opozita “dogji” mandatet dhe

zgjedhjet e ardhshme vendore rrezikojnë ta kthejnë mjedisin politik të vendit në përfaqësim njëngjyrësh politik. Nga njëra anë, media konsiderohet si shtrirje e politikës dhe/ose si një shtojcë e bizneseve të ndryshme. Kuadri i ri ligjor rristrukturoi qeverisjen vendore në Shqipëri. Pas Reformës Administrative-Territoriale të vitit 2014, u miratua legjislacioni kyç mbi funksionimin dhe organizimin e bashkive (2015) dhe financat vendore (2016), duke përfshirë akte qeveritare për decentralizimin e mëtejshëm. Aktivizmi dhe angazhimi qytetar mbeten domosdoshmëri për të kundërshtuar polarizimin politik, dhe që prej vitit 2015 “Lëviz Albania”¹ ka kontribuar në arritjen e rezultateve të prekshme në aspektin e kërkesës,

¹ “Lëviz Albania” është projekt i qeverisë zvicerane për demokracinë vendore, i zbatuar nga konsorciumi, i përbërë nga: i. Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA); ii. partnerët Shqipëri; iii. Co-Plan.



duke mbështetur aktorët e shoqërisë civile (Organizatat jofitimprurëse (OJF), grupet joformale dhe qytetarët aktivë) në kërkesën e tyre për qeverisje vendore transparente dhe llogaridhënëse, dhe shërbime publike efikase. Gjatë fazës I, “Lëviz Albania” mblodhi gjithsej 1298 projektide dhe mbështeti 166 projekte (108 nga OJF dhe 58 nga individë) në 56 bashki (92%). Projekti mbështeti veprime të përbashkëta të disa palëve të interesit, për të përmirësuar demokracinë vendore në mbarë vendin. “Lëviz Albania” është vlerësuar si aktor (markë) e rëndësishme në hedhjen e themeleve për angazhimin gjithëpërfshirës dhe veprimin qytetar në nivel vendor. Në këtë kontekst, faza II e “Lëviz Albania” do të vijojë mbështetjen e aktorëve të shoqërisë civile, duke u bazuar në përvojën e saj të mëparshme dhe në mësimet e nxjerra. Projekti do të:

- adresojë nevojën për përmirësimin e influencës së kufizuar të veprimeve të izoluar;
- trajtojë interesin dhe kapacitetin e dobët të shoqërisë civile për krijimin e rrjeteve dhe koalicioneve;
- përmirësojë synimin e mobilizimit të komunitetit, si një element kyç për qëndrueshmërinë e mbështetjes individuale;
- lehtësojë një proces më të thjeshtë aplikimi;
- synojë sjelljen në vëmendje të “Lëviz Albania” të ideve të tjera për forcimin e bazës dhe komunitetit.

Qëllimi i përgjithshëm i fazës II të “Lëviz Albania” do të jetë: Popullsia shqiptare përfiton nga demokracia e përmirësuar në nivel vendor. Për ta arritur këtë qëllim, projekti do të zbatohet krah dy rezultateve:

Rezultati 1: Aktorët e shoqërisë civile influencojnë përcaktimin e përparësive vendore, vendimarrjen dhe efikasitetin e ofrimit të shërbimeve nga autoritetet vendore.

Rezultati 2: Aktorët e shoqërisë civile angazhohen në veprime strategjike/të përbashkëta për të adresuar sfidat strukturore/sistemike, lidhur me qeverisjen e mirë në nivel vendor.

“Lëviz Albania” punon sipas qasjes nga poshtë-lart, e pasqyruar në “Teorinë e saj të ndryshimit”, mbështetur në hipotezën 5-nivelëshe të ndikimit:

1. Me fuqizimin e aktorëve vendorë dhe përmirësimin e mjedisit mundësues;

2. Qytetarët do të kërkojnë më shumë transparencë, llogaridhënie dhe hapësirë për ndikim;

3. Qytetarët ndërmarrin veprime për të ndikuar në politika dhe vendimarrje;

4. Qeveritë vendore reagojnë duke sjellë ndryshim pozitiv dhe përfitime për qytetarët/komunitetin e gjerë;

5. Promovohen modelet e suksesshme, duke frymëzuar shtrirjen e tyre në shkallë të gjerë.

Ndërhyrjet e “Lëviz Albania” për përmirësimin e demokracisë vendore gjatë fazës II do të përqendrohen në:

- Pjesëmarrje kuptimplotë dhe të përmirësuar të qytetarëve në proceset vendimarrëse vendore;²
- Qeveri vendore llogaridhënëse dhe transparente;
- Përmirësime në ofrimin e shërbimeve publike nga NJQV-të, si rezultat i kërkesës së përmirësuar nga komunitetet.

Strategjia e ndërhyrjes së LA-së do të vijojë të ndjekë të njëjtat linja bazë si në fazën I, pasi qasja nga poshtë-lart e përdorur nga LA-ja rezultoi e suksesshme. Instrumentet e fazës 2 janë:

1. Ndërhyrjet me bazë kërkesë, që synojnë të rrisin kërkesën për demokraci vendore. Ato janë përshtatur dhe ideuar për të mbështetur një grup të gjerë aktorësh vendorë, në varësi të nevojave të tyre, duke variuar nga mbështetja për komunitetin /niveli bazë (kryesisht jashtë kryeqytetit) te ndikimi në agjendën kombëtare. Bazuar në përvojën e fazës I, ndërhyrjet me bazë kërkesë do të ndërmerren në mënyrë transparente, konkurruese dhe të paanshme, duke aplikuar praktikën e mëparshme të mirënjohur të konkurseve publike të ideve.

i. Grantet e orientuara nga veprimi

- Grantet për OJF-të dhe grupet joformale;

- Nismat për Veprime Komunitare (NVK) do të synojnë qytetarët aktivë në nivel komuniteti, për t’i mbështetur dhe mobilizuar grupet ose individët në shtimin e kërkesës ndaj NJQV-ve të tyre.

- Reagimi i shpejtë do të vijojë të ofrojë mbështetje për aktorët e shoqërisë civile në situata të favorshme, nëpërmjet procedurave më fleksible.

ii) Grantet strategjike do të adresojnë sfida strukturore/sistemike dhe do të synojnë të influencojnë agjendën kombëtare, përmes nxitjes së

² Ligjet “Për njoftimin dhe konsultimin publik” dhe “Për vetëqeverisjen vendore”.



veprimeve të përbashkëta dhe krijimit të koalicionit.

2. Shërbimet mbështetëse me vlerë të shtuar janë konceptuar si shërbime vijuese të instrumenteve të përzgjedhura mundësuese strategjike të fazës I, të frymëzuara nga modelet më të mira dhe nga histori suksesi, dhe pasqyrojnë sfidat dhe mësimet e nxjerra nga zbatimi i tyre gjatë fazës I. Këto instrumente të orientuara nga shërbimi janë parashikuar të integrohen më mirë, në kuadër të veprimeve dhe prioritetëve të grantmarrësve të LA-së, duke synuar përfitimin e grantmarrësve dhe partnerëve të LA-së, përmes sigurimit të:

i. Financave bashkiake dhe perceptimeve të qytetarëve mbi shërbimet vendore, nëpërmjet mbështetjes ligjore nga klinikat e ligjit, që do të vijojnë t'i mbështesin aktorët e shoqërisë civile dhe komunitetet vendore, duke synuar kryesisht përfituesit e LA-së, duke iu përgjigjur veprimeve ligjore ndaj shkeljeve në komunitetet përkatëse, dhe duke i fuqizuar ata në ushtrimin e të drejtave të tyre socioekonomike.

ii. Të dhënave dhe njohurive të disponueshme në platformën: www.financatvendore.al.

iii. Mundësive për shkëmbim, rrjetëzim dhe këshillim, për më shumë efikasitet të sinergjisë dhe advokimit të grantmarrësve të “Lëviz Albania”.

iv. Gazetarisë së bazuar në fakte mbi çështje vendore dhe njohurive të disponueshme mbi operacionet e NJQV-ve, nëpërmjet platformës multifunksionale: www.portavendore.al, e cila synon të ndryshojë mjedisin mediatik në nivel vendor, duke fuqizuar gazetarët vendorë dhe promovuar raportimin e pavarur dhe të paanshëm.

v. Lëvizjes rinore, e cila synon të rrisë aktivizmin e të rinjve, për të influencuar vendimmarrjen dhe hedhur themele të shëndosha për kulturën demokratike të qëndrueshme.

Strategjia e zbatimit do të fokusohet në integrimin e çështjeve të Barazisë Gjinore dhe Qeverisjes së Mirë, ndërsa media do të konsiderohet si nxitës i ndryshimit dhe mjet për advokim e shpërndarje të informacionit, rezultateve dhe praktikave më të mira. Do të kërkohet në mënyrë aktive krijimi i sinergjive, kryesisht me projekte të tjera, të financuara nga Zvicra ose dhe nga donatorë të tjerë, për koordinimin e përpjekjeve, maksimizimin e rezultateve dhe shmangien e mbivendosjes.

Ndërhyrja e projektit në fazën II do të synojë: mbështetjen e të paktën 120 grantmarrësve, nga të cilët 80 janë OJF/grupe joformale dhe 40 janë individë; mbulimin e të paktën 92% të bashkive dhe përfshirjen e të paktën tri ministrive të linjës (p.sh. ministritë që mbulojnë qeverisjen vendore).

DEKRET

Nr. 13171, datë 26.7.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe të nenit 93 të Kushtetutës

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 100/2021, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) e Departamentit Federal Zviceran për Punët e Jashtme, e cila vepron përmes Ambasadës Zvicerane në Shqipëri, për projektin “Lëviz Albania”, faza e dytë, korrik 2019 – qershor 2023”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Ilir Meta

VENDIM

Nr. 125, datë 28.7.2021

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE METODOLOGJISË SË LLOGARITJES SË DËMSHPËRBLIMIT QË MBULOHEËT NGA KONTRATA E SIGURIMIT TË DETYRUESHËM NË SEKTORIN E TRANSPORTIT”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe nenit 11, pika 1, të ligjit nr. 32/2021, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare



VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për përcaktimin e rregullave dhe metodologjisë së llogaritjes së dëmshpërblimit që mbulohet nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, sipas materialit bashkëlidhur.

2. Kjo rregullore hyn në fuqi, pas botimit në Fletoren Zyrtare.

3. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
EKZEKUTIV
Ervin Mete

RREGULLORE

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
DHE METODOLOGJISË SË LLOGARITJES
SË DËMSHPËRBLIMIT QË MBULOHE
NGA KONTRATA E SIGURIMIT TË
DETYRUESHËM NË SEKTORIN E
TRANSPORTIT

*Miratuar me vendimin e Bordit nr. 125, datë
28.7.2021*

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

1. Kjo rregullore përcakton rregullat, procedurat dhe metodologjinë e llogaritjes së dëmshpërblimit që mbulohen nga kontrata e sigurimit:

a) të përgjegjësisë së pronarit/përdoruesit të mjetit motorik për dëmet e shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti;

b) të pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik;

c) të përgjegjësisë së pronarit/përdoruesit të mjetit lundrues për dëmet e shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti;

d) të përgjegjësisë së pronarit/përdoruesit të avionit për dëmet e shkaktuara palëve të treta dhe pasagjerëve nga përdorimi i këtij avioni.

2. Kjo rregullore është e detyrueshme për t'u zbatuar nga shoqëritë e sigurimit, Byroja Shqiptare e Sigurimit (BSHS) dhe vlerësuesit e dëmeve në sigurime, si dhe subjektet e tjera të cilat janë të

përfshira në zbatimin e ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe zbatim të tij.

3. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtën kuptim me ato të ligjit nr. 32/2021, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

4. Tabela nr. 1 “Koeficientët e llogaritjes së shumës së kapitalizuar” dhe tabela nr. 2 “Shkalla e humbjes së aftësisë për punë”, janë pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 32/2021, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, si dhe pikës 2 të nenit 14, të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar.

Neni 3
E drejta për dëmshpërblim

Çdo personi të cilit i është shkaktuar një dëm nga përdorimi i mjetit të transportit, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim për humbjet apo dëmtimet e pësuar, të cilat sipas rastit përbëhen nga:

1. Dëme ndaj personit.

a) dëmi pasuror me pasoje vdekjen, dëmtime ndaj personit të përkohshme dhe të përhershme;

b) dëmi jopasuror:

i. dëm biologjik;

ii. dëm moral;

iii. dëm ekzistencial.

2. Dëme ndaj pronës.

KREU II
PROCEDURA E TRAJTIMIT TË DËMIT QË
RRJEDH NGA KONTRATA E SIGURIMIT
TË DETYRUESHËM TË PËRGJEGJËSISË
SË PRONARIT TË MJETIT MOTORIK

Neni 4
Detyrimi për informimin e të siguruarit

Shoqëria e sigurimit është e detyruar që së bashku me policën e sigurimit t'i dorëzojë të siguruarit Raportin Evropian të Aksidenteve.



Shoqëria e sigurimit mund të pajisë të siguruarin dhe me fletëpalosje, në të cilën të jepen qartë të gjitha veprimet që kryhen dhe dokumentacioni që duhet, në rast se përfshihet në një aksident.

Fletëpalosja duhet të përmbajë informacion mbi:

1. Veprimet e para në momentin e përfshirjes në aksident;
2. Dokumentacionin e nevojshëm që do të shoqërojë kërkesën për dëmshpërblim;
3. Numrat e telefonit të shoqërisë së sigurimit ku mund të drejtohet për asistencë të specializuar.

Neni 5

Paraqitja e kërkesës për dëmshpërblim

1. Pala e dëmtuar ka të drejtë të paraqesë kërkesën për dëmshpërblim:

- a) te siguroesi përgjegjës i pronarit të mjetit të transportit, me të cilin është shkaktuar aksidenti;
- b) te Byroja Shqiptare e Sigurimit, në rastet e përcaktuara në nenin 41 të ligjit nr. 32/2021;
- c) te siguroesi i drejtpërdrejtë në rastet e dëmeve të shkaktuara nga mjetet e pasiguruar/ paidentifikuara, të përcaktuara në nenin 43 të ligjit nr. 32/2021;

d) te siguroesi i drejtpërdrejtë, në rast aksidenti të dy mjeteve motorike të identifikuar dhe të siguruar me kontratë sigurimi të detyrueshëm për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, në rast se midis shoqërive të sigurimit është lidhur një marrëveshje.

2. Paraqitja e kërkesës për dëmshpërblim bëhet brenda një periudhe prej 2 viteve nga data e ndodhjes së aksidentit.

3. Kërkesa për dëmshpërblim paraqitet me shkrim ose në rrugë elektronike dhe regjistrohet nga shoqëria e sigurimit/BSHS në një regjistër të veçantë.

4. Shoqëria e sigurimit/BSHS është e detyruar:

- a) të pajisë palën e dëmtuar me numrin e regjistrimit të kërkesës për dëmshpërblim. Ky numër shërben si vërtetim që pala e dëmtuar ka paraqitur një kërkesë të tillë dhe është regjistruar;
- b) të pajisë palën e dëmtuar me një formular që përmban udhëzime, instruksione dhe listën e dokumenteve të nevojshme për plotësimin e dosjes së dëmit, si dhe çdo informacion tjetër që ka lidhje me trajtimin e dosjes së dëmit;
- c) të raportojë në regjistrin elektronik të dëmeve sipas rregullave të përcaktuara në rregulloren

përkatese, brenda 1 dite pune nga momenti i hapjes së dosjes së dëmit.

5. Kërkesa për dëmshpërblim mund të jetë dhe formular standard i shoqërisë së sigurimit, që i jepet palës së dëmtuar për ta plotësuar në rast dëmi. Shoqëria e sigurimit publikon formatin e kërkesës edhe në faqen e saj zyrtare të internetit.

6. Në rastet kur kërkesa e paraqitur nuk është e plotë, shoqëria e sigurimit/BSHS i drejtohet kërkuarit me shkrim brenda 8 ditëve kalendarike pas pranimit të kërkesës ku liston të gjitha kërkesat për plotësimin e dokumentacionit.

7. Pala e dëmtuar nuk është e detyruar të përsërisë kërkesën për dëmshpërblim, në rast se identifikohet shoqëria e sigurimit të mjetit shkaktar të aksidentit. Në këtë rast shoqëria e sigurimit / BSHS që disponon kërkesën për dëmshpërblim e dërgon atë te shoqëria e sigurimit të mjetit shkaktar të dëmit brenda 3 ditëve kalendarike nga data e identifikimit të shoqërisë së sigurimit përgjegjëse. Kjo e fundit njofton palën e dëmtuar për marrjen e kërkesës për dëmshpërblim.

Neni 6

Hapja e praktikës së dëmit

1. Shoqëria e sigurimit/BSHS pasi bën regjistrimin e kërkesës për dëmshpërblim nga pala e dëmtuar, hap praktikën e dëmit.

2. Praktika e dëmit hapet e veçantë për çdo person, mjet transporti apo pronë të dëmtuar në një aksident.

3. Shoqëria e sigurimit/BSHS është e detyruar të trajtojë çdo kërkesë për dëmshpërblim sipas ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

4. Përbërja e praktikës së dëmit, në momentin e hapjes, përfshin:

- a) elementet e identifikimit të praktikës (kodi unik, numri i dosjes, kodi i degës ku hapet praktika, data dhe vendi i aksidentit);
- b) elementet e identifikimit të palës së dëmtuar (emër, mbiemër, adresa, nr. tel, adresa e postës elektronike/të dhëna për mjetin e dëmtuar / të dhëna identifikuese të pronës së dëmtuar, të dhëna për policën e sigurimit);
- c) elementet e identifikimit të shkaktarit të dëmit (ID, emër, mbiemër, adresa, nr. tel, elementet e policës së sigurimit, përfshirë dhe një kopje e saj).



d) elementet e identifikimit të pronarit të mjetit shkaktar të dëmit (ID, emër, mbiemër, adresa, nr. tel, elementet e policës së sigurimit, përfshirë dhe një kopje e saj) në rast se shkaktari i dëmit është i ndryshëm nga pronari i mjetit të transportit.

5. Shoqëritë e sigurimit/BSHS gjatë administrimit të dhënave personale të subjekteve zbatojnë detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Neni 7

Afatet e trajtimit të kërkesës për dëmshpërblim

1. Shoqëria e sigurimit është e detyruar të trajtojë kërkesën për dëmshpërblim dhe të njoftojë për masën e dëmshpërblimit sipas vlerësimit të përlogaritur nga vlerësuesi i licencuar nga Autoriteti apo për refuzimin e kërkesës për dëmshpërblim:

a) për dëme ndaj personit brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të kërkesës për dëmshpërblim;

b) për dëme ndaj pronës me vlerë mbi 100 000 (njëqind mijë) lekë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të kërkesës për dëmshpërblim.

2. Shoqëria e sigurimit kryen pagesën e dëmshpërblimit për dëme ndaj pronës me vlerë deri në 100,000 (njëqind mijë) lekë, brenda 14 (katërmëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim.

3. Për qëllim të pikave 1 dhe 2, të këtij neni, përlogaritja e afateve të trajtimit fillon nga data e depozitimit të kërkesës së bashku me dokumentacionin e plotë shoqërues.

4. Në përfundim të trajtimit të kërkesës për dëmshpërblim shoqëria duhet të njoftojë palën e dëmtuar:

a) në rast pranimi të kërkesës, për masën e dëmshpërblimit të vlerësuar prej saj;

b) në rast refuzimi të kërkesës, shkaqet ligjore me shkrim, që çojnë në këtë refuzim.

5. Shoqëria e sigurimit duhet të dokumentojë njoftimin për masën e dëmshpërblimit duke bashkëngjitur aktin e vlerësimit të dëmit apo për refuzimin e kërkesës për dëmshpërblim i cili do të bëhet për çdo rast me shkrim, duke e dërguar në adresën e palës së dëmtuar nëpërmjet organeve postare si letër rekomande ose në adresën

elektronike apo me mesazh në numrin e telefonit në rastet kur këto jepen nga kërkuesi i dëmshpërblimit në formularin e kërkesës për dëmshpërblim. Me kërkesë të palës së dëmtuar/përfituesi, shoqëria e sigurimit është e detyruar të njoftojë me shkrim masën e dëmshpërblimit apo për refuzimin e kërkesës për dëmshpërblim.

6. Pala e dëmtuar, me marrjen e njoftimit sipas pikave 4 dhe 5, të këtij neni, ka të drejtën e ankimit pranë shoqërisë së sigurimit. Shoqëria e sigurimit është e detyruar t'i përgjigjet ankimit të palës së dëmtuar brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së ankimit.

7. Siguruesi përgjegjës, gjithashtu, ka të drejtë të publikojë në faqen e internetit ose nëpërmjet programeve analoge listën e përfituesve të dëmshpërblimit dhe t'i ftojë ata të paraqiten pranë zyrave përkatëse për t'u njohur me vlerën e përlogaritur, për ta tërhequr atë nëse e pranojnë dhe për të përmbyllur praktikën përkatëse të dëmshpërblimit në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

8. Shoqëria e sigurimit duhet të kryejë pagesën e dëmshpërblimit në llogarinë bankare personale të dëmtuarit ose përfituesit.

9. Shoqëria e sigurimit për rastet e pikës 1 të këtij neni kryen pagesën e dëmshpërblimit brenda 14 (katërmëdhjetë) ditëve kalendarike pas përfundimit të trajtimit të dëmit dhe nënshkrimit të deklaratës së pranimi të dëmshpërblimit.

10. Në rast të mosrespektimit të afatit të përcaktuar në këtë nen, palës së dëmtuar i lind e drejta e përfitimit të interesit të pagueshëm për çdo ditë kalendarike vonese në shlyerjen e dëmshpërblimit nga shoqëria e sigurimit.

Neni 8

Refuzimi i dëmshpërblimit

1. Në rastin e refuzimit të kërkesës për dëmshpërblim, shoqëria e sigurimit është e detyruar të njoftojë me shkrim palën e dëmtuar për refuzimin dhe shkaqet ligjore që çojnë në këtë refuzim.

2. Pavarësisht se kërkesa për dëmshpërblim është refuzuar, shoqëria e sigurimit fillon procedurën e trajtimit të dëmit, nëse pala e dëmtuar paraqet prova të reja të kërkuara nga shoqëria e sigurimit përpara përfundimit të afatit të



parashkrimit sipas pikës 2, të nenit 5 të kësaj rregulloreje.

KREU III RREGULLAT DHE METODOLOGJIA PËR DËMIN PASUROR NDAJ PERSONIT

Neni 9

Dokumentacioni i praktikës së dëmit

Praktika e dëmit ndaj personit përmban dokumente të përgjithshme, dokumente specifike dhe dokumente të tjera.

Neni 10

Dokumente të përgjithshme

Dokumentet e përgjithshme për dëmet ndaj personit janë si më poshtë:

1. Njoftimi/kërkesa e palës së dëmtuar për dëmshpërblim e regjistruar pranë shoqërisë së sigurimit.

Pala e dëmtuar duhet të plotësojë të gjitha hapësirat e njoftimit të kërkesës për dëmshpërblim, sipas formatit të miratuar nga shoqëria e sigurimit. Gjithashtu, të shpjegojë rrethanat e ngjarjes.

2. Konfirmimi i mbulimit në sigurim nga shoqëria e sigurimit, të mjetit shkaktar të dëmit.

Konfirmimi i mbulimit në sigurim të mjetit shkaktar të dëmit, bëhet nga shoqëria e sigurimit dhe shoqërohet me policën e sigurimit të mjetit shkaktar të dëmit.

3. Llogaria bankare e përfituesit/dëmtuarit në një bankë të nivelit të dytë për kryerjen e pagesës së dëmshpërblimit nga shoqëria e sigurimit/BSHS.

4. Proces verbali i konstatimit të shkeljes nga policia rrugore për ngjarjen dhe/ose vendim nga organet gjyqësore për përcaktimin e shkaktarit të aksidentit dhe/ose dokumentacioni i procedimit penal për përcaktimin e shkaktarit të aksidentit.

Neni 11

Dokumente specifike

Dokumentet specifike për dëmet ndaj personit janë si më poshtë:

1. Certifikata familjare, certifikata e trungut familjar në momentin e aksidentit dhe letërnjoftim ID për të dëmtuarin.

Certifikata familjare e personit të dëmtuar, certifikata e trungut familjar në rastin e paaftësisë së përhershme (pjesore ose totale) dhe të përkohshme, duhet të jetë sipas formatit zyrtar, e nënshkruar dhe e vulosur nga organi kompetent.

2. Vërtetimi i të ardhurave neto personale për tri vitet e fundit.

Vërtetimi i të ardhurave neto personale për tri vitet e fundit (duke filluar nga data e aksidentit), i detajuar për çdo muaj i lëshuar nga organet kompetente përkatëse.

Neni 12

Dokumente të tjera specifike

1. Për dëme ndaj personit me pasojë vdekje, përveç atyre të parashikuara në nenet 10 dhe 11, do të përfshihen edhe dokumentet e mëposhtme:

a) skeda e vdekjes;

b) certifikata e vdekjes;

c) akti i përcaktimit të trashëgimtareve të të ndjerit.

2. Për dëme ndaj personit me paaftësi të përhershme, përveç atyre të parashikuara në nenet 10 dhe 11, do të përfshihen edhe dokumentet e mëposhtme:

a) raporti i paaftësisë së përhershme për punë i cili duhet të shprehë në përqindje masën e paaftësisë, duke u bazuar në tabelën nr. 2 “Shkalla e humbjes së paaftësisë së përhershme në punë” bashkëlidhur kësaj rregulloreje;

b) radiografi/ skaner/ rezonancë magnetike/ epikrizë/anamnezë, fletështrimi dhe fletëdalja nga spitali dhe çdo dokument tjetër që ndihmon në vlerësimin e dëmit i lëshuar nga organet kompetente.

3. Për dëme ndaj personit me paaftësi të përkohshme, përveç atyre të parashikuara në nenin 10, do të përfshihet edhe raporti i paaftësisë së përkohshme, i cili do të përcaktohet nga organi kompetent shëndetësor si dhe dokumenti i të ardhurave të përfituara për periudhën e paaftësisë së përkohshme.

Neni 13

Dokumente të tjera të praktikës së dëmit

1. Përveç sa është parashikuar në nenet 10, 11 dhe 12, të kësaj rregulloreje, çdo praktikë dëmi duhet të përmbajë edhe dokumentet e mëposhtme:



a) aktvlerësimi i demit;

Aktivlerësimi i demit kryhet vetëm nga vlerësuesi i dëmeve i licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Në aktivlerësim do të përfshihen të gjitha elementet e domosdoshme që kërkojnë shpenzime.

b) relacion përmbledhës, ku pasqyrohet gjithë procesi, nga hapja e dosjes deri në përfundim. Në relacion duhet të përfshihet opiniononi për vërtetësinë e rastit të sigurimit;

c) deklarata e pranimit të dëmshpërblimit, e cila do të shërbejë si provë për pranimin e vlerës së dëmshpërblimit nga pala e dëmtuar;

d) dokumenti që vërteton njoftimin e palës së dëmtuar për masën dëmshpërblimit apo për refuzimin e kërkesës për dëmshpërblim, sipas pikës 5, të nenit 7, të kësaj rregulloreje.

2. Përveç sa është parashikuar në këtë nen, praktika e demit mund të përmbajë edhe dokumente të tjera plotësuese që lidhen me trajtimin e dosjes së demit.

Neni 14

Përlllogaritja e dëmit ndaj personit me pasojë paaftësinë e përhershme për punë

1. Bazuar në pikën 3, germa “a”, të nenit 25, të ligjit nr. 32/2021, në rastin e dëmeve me pasojë paaftësi të përhershme për punë, kur vërtetohet humbja e të ardhurave, përfutimi llogaritet si produkt i të ardhurave vjetore neto me koeficientin e shumës së kapitalizuar, moshës së daljes në pension dhe humbjes së aftësisë për punë.

Përlllogaritja e dëmit ndaj personit me pasojë paaftësinë e përhershme në punë bëhet sipas kësaj formule:

$$D = T_{ap} \cdot K_{Shk} \cdot K_{mdp} \cdot K_{hap}$$

ku:

D – dëmshpërblimi

T_{ap} – të ardhurat personale vjetore

K_{Shk} – koeficienti i shumës së kapitalizuar;

K_{mdp} – koeficienti i moshës së daljes në pension;

K_{hap} – koeficienti i humbjes së aftësisë për punë.

Vlerës së dëmshpërblimit të llogaritur sipas pikës 1, të këtij neni, do t'i shtohen edhe shpenzimet spitalore e farmaceutike të kryera nga i

dëmtuari brenda periudhës së paaftësisë dhe të vërtetuar me dokumente të rregullta.

2. Do të konsiderohen të ardhura personale vjetore **(Tap)**:

a) në rast se i/e dëmtuari/a ka qenë në marrëdhënie pune në momentin e aksidentit, do të referohet në mesataren e të ardhurave neto për 3 vitet e fundit të konfirmuara nga organet kompetente;

b) në rast se i/e dëmtuari/a ka qenë i vetëpunësuar do të referohet në mesataren e të ardhurave neto për 3 vitet e fundit të deklaruara dhe të konfirmuara nga organet përkatëse;

c) në rast se i/e dëmtuari/a nuk ka qenë në marrëdhënie pune në kohën e ngjarjes do të referohet në pagën minimale zyrtare bruto të vendbanimit në kohën e ngjarjes;

d) në rast se i/e dëmtuari/a ka qenë i punësuar jashtë vendit do të referohet në mesataren e të ardhurave neto për 3 vitet e fundit, e konfirmuar nga organet kompetente;

e) në rast se i/e dëmtuari/a ka qenë në pension, shuma e pensionit që ka marrë vitin e fundit e shprehur në bazë vjetore;

f) fitimi i shoqërisë (i shpërndarë ose jo), nuk llogaritet në të ardhurat personale të aksionerit/ortakut;

g) për periudhat në të cilën i dëmtuari nuk ka qenë në marrëdhënie pune, në llogaritjen e të ardhurave për 3 vitet sipas pikave “a”, “b”, “d” të mësipërme, do të merret në konsideratë paga minimale zyrtare bruto e periudhës;

h) për të dëmtuarit e mitur (deri në 16 vjeç) dhe të papunë, si e ardhur vjetore do të merret paga minimale zyrtare bruto e vendbanimit në kohën e ngjarjes.

3. Koeficienti i shumës së kapitalizuar (**Kshk**) paraqitet në tabelën nr. 1 “Koeficientët e llogaritjes së shumës së kapitalizuar”, bashkëngjitur kësaj rregulloreje.

4. Koeficienti i moshës së daljes në pension (**Kmdp**), llogaritet:

a) në rast se i/e dëmtuari/a ka qenë në pension, koeficienti i moshës së daljes në pension do të merret 0.80;

b) në rast se i/e dëmtuari/a nuk ka qenë në pension, koeficienti i moshës së daljes në pension do të merret 0.90.

5. Koeficienti i humbjes së aftësisë për punë **Khap** jepet nga KMCAP-i (Komisioni Mjekësor i



Caktimit të Aftësisë për Punë) ose komisioni mjekësor i ngritur nga shoqëria e sigurimit, duke u mbështetur në tabelën nr. 2 (shkalla e humbjes së aftësisë për punë), bashkëngjitur kësaj rregulloreje. Komisioni përbëhet nga të paktën 3 mjekë specialistë të fushave të ndryshme.

6. Për të dëmtuarit nën 12 vjeç, për efekt llogaritjeje merret koeficienti i llogaritjes së shumës së kapitalizuar që i korrespondon moshës 12 vjeç.

7. Për të dëmtuarit mbi 80 vjeç, për efekt llogaritjeje merret koeficienti i llogaritjes së shumës së kapitalizuar që i korrespondon moshës 80 vjeç.

Neni 15

Përlllogaritja e dëmit ndaj personit me pasojë vdekje

1. Bazuar në pikën 3, germa “b”, të nenit 25, të ligjit 32/2021, në rastet e dëmeve me pasojë vdekje, dëmi pasuror do të llogaritet si në rastin e paaftësisë së plotë të përhershme me ndryshimin që nga të ardhurat sipas nenit 14 të kësaj rregulloreje, të zbriten të ardhurat për nevojat e vetë personit, të cilat varen nga numri i personave në familje.

Përlllogaritja e dëmit ndaj personit me pasojë vdekje bëhet sipas kësaj formule:

$$D = (T_{ap} - K_{avnp} \cdot T_{ap}) K_{shk} \cdot K_{mdp}$$

ku:

D – dëmshpërblimi

T_{ap} – të ardhurat personale vjetore

K_{avnp} – koeficienti i të ardhurave për vetë nevojat e personit

K_{shk} – koeficienti i shumës së kapitalizuar

K_{mdp} – koeficienti i moshës së daljes në pension

2. Të ardhurat personale, koeficienti i shumës së kapitalizuar dhe koeficienti i moshës së daljes në pension janë të njëjta me përcaktimet e dhëna në nenin 14, të kësaj rregulloreje.

3. Përqindja e të ardhurave për nevojat e vetë personit (**K_{avnp}**) do të jetë si më poshtë:

a) kur i ndjeri ka pasur në familje tre ose më shumë se tre persona (pa të ndjerin) pjesa që do të zbritet është 30% e të ardhurave;

b) kur i ndjeri ka pasur në familje dy persona (pa të ndjerin) pjesa që do të zbritet është 40% e të ardhurave;

c) kur i ndjeri ka pasur në familje një person (pa të ndjerin) pjesa që do të zbritet është 50% e të ardhurave.

4. Kur i ndjeri është nën moshën 16 vjeç, trashëgimtarët e tij do të dëmshpërblehen në shumën fikse prej 2,500,000 lekë.

5. Nëse trashëgimtarët e të ndjerit janë të mitur, dëmshpërblimi do të depozitohet në emër të tyre në një bankë të nivelit të dytë, e cila operon në Republikën e Shqipërisë.

6. Në vlerën e dëmshpërblimit me pasojë vdekje do të shtohen edhe shpenzimet e varrimit në shumën fikse prej 300,000 lekë.

7. Nëse i ndjeri ka qenë i vetëm në familje do të paguhen vetëm shpenzimet e varrimit. Këto shpenzime i paguhen subjektit që ka kryer shërbimet funerale ose shtetit.

Neni 16

Përlllogaritja e dëmit ndaj personit me pasojë paaftësinë e përkohshme në punë

1. Bazuar në pikën 3, germa “c”, të nenit 25, të ligjit nr. 32/2021, në rastet e dëmeve me pasojë paaftësinë e përkohshme, humbja financiare përbën pjesën e papaguar të pagës për kohën e paaftësisë.

2. Humbja e përkohshme e aftësisë për punë përcaktohet nga organi kompetent shëndetësor, për një periudhë deri në 6 muaj.

3. Kur i dëmtuari është i punësuar në sektorin privat apo publik, dëmshpërblimi mujor llogaritet si diferencë midis pagës të muajit të fundit para aksidentit dhe pagës që përfitohet nga raportet mjekësore.

4. Kur i dëmtuari është i papunë, dëmshpërblimi i përfituar sipas pikës 2 të këtij neni, llogaritet me formulën e mëposhtme:

$$D = \frac{P_{mz} \cdot P_{rd}}{d}$$

ku:

D – dëmshpërblimi

P_{mz} – paga minimale zyrtare

P_{rd} – periudha e paaftësisë së përkohshme në ditë pune

d – 22 ditë

5. Përveç dëmshpërblimit të shprehur në pikat 2, 3 dhe 4, të këtij neni, të dëmtuarit do t'i paguhen edhe shpenzimet spitalore e farmaceutike të kryera nga ai brenda periudhës së paaftësisë së



përkohshme dhe të vërtetuara me dokumente të rregullta përkatëse.

6. Kur i dëmtuari është i mitur (nën 16 vjeç), ose pensionist si dëmshpërblim do të konsiderohen pagesat e shpenzimeve spitalore e farmaceutike të kryera nga ai.

KREU IV RREGULLAT DHE METODOLOGJIA PËR DËMIN JOPASUROR NDAJ PERSONIT

Neni 17 Dëmi jopasuror

1. Çdo personi të cilit i është shkaktuar një dëm nga përdorimi i mjetit të transportit brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 25, të ligjit nr. 32/2021, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim për dëme jopasurore.

2. Dëmi jopasuror është dëmi biologjik, ekzistencial dhe moral i pësuar nga cenimi i të drejtave dhe i interesave jopasurore, që lidhet me dhimbjet fizike, paaftësinë për punë, frikën, shëmtimin, dhimbjet dhe vuajtjet shpirtërore të personit të dëmtuar dhe familjarëve të tij në rastin e vdekjes së personit ose përkeqësimit të shëndetit të tij.

3. Dëmi jopasuror përbëhet nga:

- a) dëm biologjik;
- b) dëm moral;
- c) dëm ekzistencial.

Neni 18 Dëmi biologjik

1. Dëmi biologjik përbën në thelb cenimin e së mirës së shëndetit, të integritetit fizik dhe/ose psikik të njeriut dhe që ka një ndikim negativ në aktivitetin jetësor të përditshëm, në aspektin dinamik dhe ndërpersonal të jetës së palës së dëmtuar, pavarësisht kthimit të mundshëm të kapacitetit të tij për të siguruar të ardhura.

2. Dëmi biologjik llogaritet për çdo person të dëmtuar sipas moshës dhe shkallës së paaftësisë së pësuar. Vlera e dëmit biologjik për çdo person të dëmtuar do të jetë jo më shumë se 110 000 (njëqind e dhjetë mijë) lekë për çdo 10% të shkallës së paaftësisë së përhershme, të pjesshme ose të plotë.

3. Dëmi biologjik llogaritet, si më poshtë:

Deri në moshën 20 vjeç	
a) deri në 30%	100,000 lekë
mbi 30%	110,000 lekë
Prej moshës 21 vjeç deri në 30 vjeç	
b) deri në 30%	85,000 lekë
mbi 30%	100,000 lekë
Prej moshës 31 vjeç deri në 50 vjeç	
c) deri në 30%	50,000 lekë
mbi 30%	85,000 lekë
Prej moshës 51 vjeç deri në 70 vjeç	
c) deri në 30%	40,000 lekë
mbi 30%	65,000 lekë
Mbi moshën 70 vjeç	
d) deri në 30%	35,000 lekë
mbi 30%	55,000 lekë

Neni 19 Dëmi moral

1. Dëmi moral është shfaqje e brendshme e turbullimit të gjendjes shpirtërore të njeriut, dhimbje e vuajtje shpirtërore individuale dhe e familjarëve të të dëmtuarit.

2. Përlllogaritja e dëmit moral me pasojë paaftësinë e përhershme, kryhet si më poshtë:

a) Vlera e dëmit moral për çdo person të dëmtuar, me pasojë paaftësi të përhershme për punë, përlllogaritet në varësi të shkallës së paaftësisë si vijon:

- deri në 30% paaftësi, pala e dëmtuar do të përfitojë e dëmit biologjik;
- mbi 30% deri në 45%, pala e dëmtuar do të përfitojë e dëmit biologjik;
- mbi 45% deri në 60%, pala e dëmtuar do të përfitojë sa vlera e dëmit biologjik;
- mbi 60% deri në 75%, pala e dëmtuar do të përfitojë e dëmit biologjik;
- mbi 75% pala e dëmtuar do të përfitojë e dëmit biologjik.

b) Vlera e dëmit moral për secilin nga familjarët e të dëmtuarit/ës, prind/ fëmijë/ bashkëshort, do të jetë jo më shumë se 1/5 e përfitimit të dëmtuarit me pasojë paaftësinë e përhershme për punë sipas pikës 2, germa a), të këtij neni;

c) Vlera e dëmit moral për secilin nga familjarët vëlla/motër vlera e përfitimit do të jetë jo më shumë se 1/2 e shumës që përfiton secili nga familjarët prind/bashkëshort/fëmijë.



3. Përlllogaritja e dëmit moral me pasojë vdekjen, bëhet si më poshtë:

a) vlera e dëmit moral për secilin nga familjarët e të ndjerit/ës, prind/ fëmijë/ bashkëshort, për vdekjen e të afërmit do të jetë jo më shumë se 220 000 (dyqind e njëzet mijë) lekë;

b) vlera e dëmit moral për secilin nga familjarët e të ndjerit/ës, vëlla/motër vlera e përfitimit është jo më shumë se 1/2 e shumës që përfiton secili nga familjarët prind/ bashkëshort/ fëmijë.

4. Dëmi moral me pasojë paaftësinë e përkohshme është jo më shumë se 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë për çdo muaj paaftësi të përkohshme.

Neni 20

Dëmi ekzistencial

1. Dëmi ekzistencial është cenimi i të drejtave të personalitetit të njeriut duke dëmtuar në mënyrë të përhershme shprehjen e të dëmtuarit si njeri, ose të familjarëve të tij në botën e jashtme, duke tronditur objektivisht jetën e përditshme dhe veprimtarinë e zakonshme të tij, si në cilësinë e jetës, ashtu dhe në marrëdhëniet personale dhe familjare.

2. Përlllogaritja e dëmit ekzistencial me pasojë paaftësinë e përhershme, kryhet si më poshtë:

a) Vlera e dëmit ekzistencial për çdo person të dëmtuar, me pasojë paaftësi të përhershme për punë, përlllogaritet në varësi të shkallës së paaftësisë si vijon:

- deri në 30% paaftësi, pala e dëmtuar do të përfitojë e dëmit biologjik;

- mbi 30% deri në 45%, pala e dëmtuar do të përfitojë e dëmit biologjik;

- mbi 45% deri në 60%, pala e dëmtuar do të përfitojë sa vlera e dëmit biologjik;

- nga 60% deri në 75%, pala e dëmtuar do të përfitojë e dëmit biologjik;

- mbi 75% pala e dëmtuar do të përfitojë e dëmit biologjik.

b) Vlera e dëmit ekzistencial për secilin nga familjarët e të dëmtuarit/ës, prind/ fëmijë/ bashkëshort, do të jetë jo më shumë se 1/5 e përfitimit të dëmtuarit me pasojë paaftësinë e përhershme sipas pikës 2, germa “a”, të këtij neni;

c) Vlera e dëmit ekzistencial për secilin nga familjarët vëlla/motër vlera e përfitimit jo më shumë se 1/2 e shumës që përfiton secili nga familjarët prind/bashkëshort/fëmijë.

3. Përlllogaritja e dëmit ekzistencial me pasojë vdekjen, bëhet si më poshtë:

a) Vlera e dëmit ekzistencial për secilin nga familjarët e të ndjerit/ës, prind/ fëmijë/ bashkëshort, për vdekjen e të afërmit do të jetë jo më shumë se 220 000 (dyqind e njëzet mijë) lekë;

b) Vlera e dëmit ekzistencial për secilin nga familjarët e të ndjerit/ës, vëlla/motër vlera e përfitimit është jo më shumë se 1/2 e shumës që përfiton secili nga familjarët prind/ bashkëshort/ fëmijë.

4. Dëmi ekzistencial me pasojë paaftësinë e përkohshme është jo më shumë se 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë për çdo muaj paaftësi të përkohshme.

Neni 21

Kufiri i mbulimit të përgjegjësisë

1. Kufiri i mbulimit të përgjegjësisë ndaj palëve të treta pavarësisht nga përlllogaritjet e bëra sipas kësaj rregulloreje nuk duhet të tejkalojnë në asnjë rast limitet e përcaktuara në nenin 25, pika 5, të ligjit nr. 32/2021.

2. Në rast se ka disa palë të dëmtuara nga një ngjarje sigurimi dhe vlera totale e dëmshpërblimit për dëmin ndaj personit, si dhe vlera totale e dëmshpërblimit për dëmin ndaj pronës tejkalon shumat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, shuma e dëmshpërblimit dhe të drejtat e palëve të dëmtuara ndaj shoqërisë së sigurimit zvogëlohen në mënyrë përpjesëtimore për secilën figurë të dëmit ndërmjet të gjithë të dëmtuarve deri në përfundim të gjithë shumës së siguruar sipas kontratës së sigurimit.

KREU V

TRAJTIMI I TË DËMTUARVE ME SHËRBIME MJEKËSORE JASHTË VENDIT

Neni 22

Procedurat e kurimit të të dëmtuarve jashtë vendit

1. Në kuptim të kësaj rregulloreje do të konsiderohen të dëmtuar që kurohen jashtë



vendit të gjithë ata të dëmtuar që përfitojnë nga ligji nr. 32/2021 dhe që rekomandohen për kurim jashtë vendit nga komisioni përkatës pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.

2. Komisioni arsyeton mbi mundësinë e kurimit të të dëmtuarit brenda, apo jashtë vendit dhe shprehet për rastet kur është i nevojshëm kurimi jashtë vendit, duke rekomanduar edhe klinikën që do të kurohet.

3. Për çdo të dëmtuar, shoqëria e sigurimit duhet të bjerë dakord rast pas rasti me klinikën që merr përsipër kurimin, për çmimin për çdo ditë qëndrimi të të dëmtuarit dhe shoqëruesin e tij, llojin e ndërhyrjeve, numrin e tyre, çmimin për çdo ndërhyrje dhe afatin e kurimit.

4. Klinika kuruese do të paguhet nga shoqëria që ka siguruar mjetin shkaktar të dëmit, sipas faturave të paraqitura. Këto shpenzime konsiderohen dëmshpërblim për të dëmtuarin.

5. Nëse i dëmtuari edhe pas kurimit jashtë vendit rezulton me paaftësi të përhershme për punë, për dëmshpërblim të mëtejshëm të tij do të veprohet sipas rregullave mbi “Përlllogaritja e dëmit ndaj personit me pasoje paaftësinë e përhershme për punë (përkeqësim shëndeti)”.

6. Kur të dëmtuarit kurohen jashtë vendit pa miratimin me shkrim sipas procedurave të përmendura më lart, dëmshpërblimi do të llogaritet sipas nenit 14 “Përlllogaritja e dëmit ndaj personit me pasoje paaftësinë e përhershme për punë (përkeqësim shëndeti)”, si dhe nenit 17 e vijues të kësaj rregulloreje.

7. Përjashtim konsiderohen rastet, vetëm kur personi i dëmtuar për shkaqe shëndetësore urgjente që rrezikojnë jetën e tij, duhet të kurohet jashtë vendit.

KREU VI RREGULLAT DHE METODOLOGJIA PËR DËMIN NDAJ PRONËS

Neni 23

Dokumentacioni i praktikës së dëmit

Praktika e dëmit ndaj pronës përmban dokumente të përgjithshme, dokumente specifike dhe dokumente të tjera.

Neni 24

Dokumente të përgjithshme

Dokumentet e përgjithshme për dëmet ndaj pronës janë si më poshtë:

1. Njoftimi/kërkesa e palës së dëmtuar për dëmshpërblim e regjistruar pranë shoqërisë së sigurimit.

Pala e dëmtuar duhet të plotësojë të gjitha hapësirat e njoftim kërkesës për dëmshpërblim, sipas formatit të miratuar nga shoqëria e sigurimit. Gjithashtu të shpjegojë me hollësi rrethanat e ngjarjes.

2. Konfirmimi i mbulimit në sigurim nga shoqëria e sigurimit, të mjetit shkaktar të dëmit.

Konfirmimi i mbulimit në sigurim të mjetit shkaktar të dëmit, bëhet nga shoqëria e sigurimit dhe shoqërohet me kopje të policës së sigurimit të mjetit shkaktar të dëmit.

3. Llogaria bankare dhe emri i bankës për kryerjen e pagesës së dëmshpërblimit nga shoqëria e sigurimit/BSHS.

4. Procesverbali i konstatimit të shkeljes nga Policia Rrugore për ngjarjen ose Raporti Evropian i Aksidenteve / Vendim nga organet gjyqësore për përcaktimin e shkaktarit të aksidentit.

Neni 25

Dokumente specifike

Dokumentet specifike për dëmet ndaj pronës janë si më poshtë:

1. Dokumenti i pronësisë së mjetit ose objektit të dëmtuar.

2. Aktekspertimi i dëmit.

Aktekspertimi i dëmit duhet të hartohet nga specialisti i shoqërisë së sigurimit në vendndodhjen e objektit të dëmtuar, në prani dhe të palës së dëmtuar ose të përfaqësuesit të tij.

Akti i ekspertimit duhet të hartohet brenda 10 ditëve kalendarike nga data e njoftimit të aksidentit nga pala e dëmtuar.

Aktekspertimi i dëmit duhet të jetë i nënshkruar nga të dyja palët.

3. Foto të mjetit shkaktar të dëmit.

Fotoja e mjetit shkaktar të dëmit, duhet të paraqesë në mënyrë të qartë targën dhe pjesët e dëmtuara si rrjedhojë e ngjarjes.

4. Foto të mjetit ose objektit të dëmtuar.



Foto e mjetit ose objektit të dëmtuar duhet të bëhet nga shoqëria e sigurimit që hap dosjen e dëmit gjatë procesit të ekspertimit. Praktika e dëmit duhet të përmbajë jo më pak se 3 (tri) foto të mjetit/objektit të dëmtuar në pozicione të ndryshme. Në foto duhet të paraqiten qartë pjesët e dëmtuara, si dhe në një nga fotot të pasqyrohet qartë pamja e përgjithshme e mjetit të dëmtuar së bashku me targën e tij.

Neni 26

Dokumente të tjera të praktikës së dëmit

Përveç sa është parashikuar në nenet 24 dhe 25 të kësaj rregulloreje, çdo dosje dëmi duhet të përmbajë edhe dokumentet e mëposhtme:

1. Aktvlerësimi i dëmit.

Aktivlerësimi i dëmit kryhet vetëm nga vlerësuesi i dëmeve i licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Në aktivlerësim do të përfshihen të gjitha elementet e domosdoshme që kërkojnë shpenzime.

2. Relacion përmbledhës, ku pasqyrohet gjithë procesi, nga hapja e dosjes deri në përfundim. Në relacion duhet të përfshihet opiniononi për vërtetësinë e rastit të sigurimit.

3. Deklarata e pranimit të dëmshpërblimit, e cila do të shërbejë si provë për pranimin e vlerës së dëmshpërblimit nga pala e dëmtuar.

4. Dokumenti siç përcaktohet në nenin 7, pika 4, që vërteton marrjen nga i dëmtuari të njoftimit për masën e dëmshpërblimit apo për refuzimin e kërkesës për dëmshpërblim.

Përveç sa është parashikuar në këtë nen, praktika e dëmit mund të përmbajë edhe dokumente të tjera plotësuese që lidhen me trajtimin e dosjes së dëmit.

Neni 27

Dokumentet e praktikës së dëmit që trajtohen me Raportin Evropian të Aksidenteve

Dokumentet për trajtimin e kërkesës për dëmshpërblim për dëme me vlerë deri 30 mijë lekë, për të cilat palët kanë nënshkruar Raportin Evropian të Aksidentit përfshijnë:

1. Formularin e Raportit Evropian të Aksidenteve.

Raporti Evropian i Aksidenteve (sipas formatit të miratuar nga Autoriteti), duhet të paraqitet nga pala e dëmtuar. Formulari duhet të plotësohet me korrektësi nga pjesëmarrësit në aksident dhe të jetë i nënshkruar nga këta pjesëmarrës. Ky formular konsiderohet kërkesë për dëmshpërblim.

2. Fotografia në momentin e aksidentit të mjeteve të dëmtuara.

Fotografia të mjeteve të dëmtuara duhet të bëhen para lëvizjes së mjeteve nga një distancë e afërt dhe e largët (dëmtimin e mjeteve, gjurmët e frenimit, mbeturinat e rëna në rrugë) dhe gjurmët e rëndësishme si pozicioni i mjeteve, i rrotave etj. Fotografitë duhet të jenë në mënyrë të qartë duke pasqyruar pjesët e dëmtuara dhe targën e mjeteve.

Mungesa e fotografive kërkon ekspertizën e mjetit të dëmtuar nga ana e shoqërisë së sigurimit përgjegjëse.

3. Dokumentet e identifikimit të palëve të përfshira në aksident (ID);

4. Dokumentet e mjeteve dhe drejtuesve të tyre (leje qarkullimi, leje drejtimi, kopje e policave të sigurimit).

KREU VII

METODOLOGJIA E PËRLLLOGARITJES SË DËMIT NDAJ PRONËS

Neni 28

Kategorizimi i mjeteve

Mjetet motorike në varësi të vitit të prodhimit ose vënies në qarkullim kategorizohen si më poshtë:

Grupi i parë: përfshihen mjete të prodhuara ose të vëna në qarkullim në interval kohor ushtrimor 4 (katër) vjet përpara ditës së dëmit;

Grupi i dytë: përfshihen mjete të prodhuara ose të vëna në qarkullim në interval kohor ushtrimor 6 (gjashtë) vjet përpara atij të grupit të parë;

Grupi i tretë: përfshihen mjete të prodhuara ose të vëna në qarkullim në intervalin kohor përpara grupit të dytë.



Neni 29

Dokumentacioni që përcakton grupin e mjetit

1. Dokumentacioni që përcakton grupin e mjetit është:

- a) leje e qarkullimit të mjetit;
- b) certifikata e pronësisë së mjetit.

2. Dokumentacioni i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni duhet të paraqitet: Original ose kopje e noterizuar e tij.

3. Në mungesë të dokumentacionit të përmendur në pikën 1, përcaktimi i grupit do të bëhet nëpërmjet botimeve të fundit të katalogëve ndërkombëtare të njohura.

Neni 30

Vlerësimi i dëmit ndaj pronës

1. Mënyra e llogaritjes së vlerës së dëmshpërblimit do të zgjidhet në funksion të amortizimit të mjetit motorik, vlerës aktuale dhe gjendjes teknike të tij, mundësisë për sigurimin e pjesëve të këmbimit, nivelit të kërkesave për riparim etj.

2. Pas kryerjes së ekspertimit të dëmit dhe vlerësimit të mjetit para ngjarjes, kryhet vlerësimi i dëmit duke e pasqyruar atë në aktvlerësim dëmi. Aktvlerësimi detyruesisht përmban:

Në pjesën e parë:

Emrin e përfituesit të dëmit.

Emrin e shkaktarit të dëmit në momentin e aksidentit. Policën e sigurimit të mjetit shkaktar të dëmit.

Në pjesën e dytë:

Të gjitha elementet që pasqyrohen në këtë pjesë plotësohen gjatë ekspertimit fizik të mjetit të dëmtuar me qëllim që të bëhet më pas krahasimi me dokumentacionin përkatës që i korrespondon mjetit.

Në pjesën e tretë:

Përshkruhen dëmtimet dhe numri i pjesëve të dëmtuara dhe shënohet emërtimi i pjesës, gjendja e automjetit dhe mënyra e riparimit, në varësi të shkallës së dëmtimit duke i ndarë në:

- a) pjesë për ndërrim;
- b) pjesë për riparim (L, M, V);
- c) pjesë për kontroll dhe adoptim.

3. Si në rastin e dëmtimit pjesor apo shkatërrimit total të pronës, dëmshpërblimi ndaj

pronës në asnjë rast nuk duhet të tejkalojë vlerën aktuale të pronës së dëmtuar duke u bazuar në parimin e zëvendësimit.

4. Në vlerën e dëmshpërblimit duhet të përfshihen dhe shpenzimet për transportin e mjetit motorik, shpenzime ruajtjeje dhe shpenzime gjyqësore apo noteriale.

5. Shoqëria e sigurimit është e detyruar t'i ofrojë palës së dëmtuar dëmshpërblim në vlerë monetare ose riparim të mjetit në servis.

6. Elementet e detajuara të vlerësimit të dëmit ndaj mjetit përcaktohen në manualët e dëmeve të shoqërive. Manualët e shoqërive dhe çdo ndryshim i kryer në to duhet të depozitohen në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

Neni 31

Ndërrimi i pjesëve të dëmtuara

1. Për dëmtime, për të cilat nuk ekzistojnë mundësitë teknike për një riparim cilësor dhe ekonomik, do të kryhet ndërrimi i pjesëve ose i strukturës së mjetit motorik.

2. Nëse mjeti nuk ka dëmtime të mëdha, ndërrohen:

- a) pjesët e dëmtuara të cilat ndikojnë në sigurinë e automjetit;
- b) pjesët e dëmtuara të cilat me riparimin e tyre, nuk mund të kthehen në gjendjen e mëparshme nga ana estetike;
- c) struktura të pjesshme, të cilat duhen të jenë në harmoni me udhëzimet e prodhuesit.

3. Nëse, si rezultat i aksidentit, ka thyerje të xhamit të mjetit, duhet të përcaktohet saktësisht lloji i xhamit, cilësia e tij, mënyra e ngjites si dhe cilësi të tjera të cilat kanë rëndësi në vlerësimin real të dëmit.

4. Nëse për shkak të dëmtimeve të mëdha, është e domosdoshme ndërrimi i pjesëve të cilat (edhe të ngjashme) nuk gjenden në treg, me pëlqimin e palës së dëmtuar mund të bëhet riparimi i pjesës së dëmtuar, duke kërkuar dhe një kohë shtesë për këtë riparim.

5. Automjeti do të konsiderohet jashtë përdorimi kur kostoja e riparimit është mbi 80% e vlerës së mjetit ose kur riparimi i mjetit është teknikisht i pamundur. Në këto raste shoqëria e sigurimit do të kompensojë palën e dëmtuar në vlerën e plotë të mjetit, përveç rasteve kur



shoqëria e sigurimit bie dakord me palën e dëmtuar për pjesën e mbetur të mjetit.

Neni 32

Pjesët për riparim

1. Pjesët e dëmtuara të mjetit riparohen, me kusht që të ruhet siguria e mjetit;

2. Shkalla e dëmtimit të mjetit ndahet në:

a) dëmtime të vogla (V), konsiderohen dëmtime në pjesët e jashtme pa deformime të mëdha, pjesët e dëmtuara mund të riparohen lehtë me pak orë punë dhe materiale, si dhe gjenden në pozicione të përshtatshme për t'u riparuar;

b) dëmtime të mesme (M), konsiderohen dëmtime të cilat janë të dukshme dhe të theksuara dhe gjenden në pozicione të papërshtatshme për t'u riparuar;

c) dëmtime të larta (L) konsiderohen dëmtime me deformime të mëdha dhe gjenden në vende jashtëzakonisht të papërshtatshme për riparim.

Neni 33

Pjesët për kontroll dhe adoptim

Nëse dëmtimi i mjetit, si pasojë e aksidentit ndikon në rregullimin gjeometrik të pjesëve të dëmtuara ose ndërlidhëse të mjetit është i nevojshëm kontrolli konkret i tij dhe, veçanërisht:

1. Gjeometria e rrotave;
2. Gjeometria e pikave matëse të karrocërës, shasisë etj.;
3. Sistemi i drejtimit, rezervuari i karburantit etj.

Neni 34

Riparimi i mjetit në servis

1. Riparimi në servis aplikohet në rastet kur mjeti i dëmtuar autorizohet, me pëlqimin e palës së dëmtuar, për t'u riparuar në servis.

2. Autorizimi për riparimin e mjeteve në servis jepet vetëm nga personi i autorizuar i shoqërisë së sigurimit.

3. Riparimi i mjetit të dëmtuar kryhet vetëm në servise të regjistruara pranë organeve tatimore me të cilët është lidhur më parë aktmarrëveshja përkatëse nga shoqëria e sigurimit.

4. Ekspertimi i mjetit të dëmtuar bëhet i përbashkët ndërmjet ekspertit të shoqërisë së sigurimit, përfaqësuesit të servisit dhe palës së tretë/të dëmtuarit dhe firmoset prej tyre.

5. Secila palë ka të drejtë të pajiset me një kopje të aktekspertimit të dëmit.

6. Riparimi konsiderohet i përfunduar kur pala e tretë/i siguruari nënshkruan formularin “Deklarimi i pranimit të riparimit të mjetit”.

7. Dorëzimi i mjetit nga ana teknike, para dhe pas riparimit, bëhet me procesverbal në prani të përfaqësuesit të servisit, palës së tretë/të siguarit.

8. Dëmshpërblimi i paguhet palës së tretë/të siguarit, përfaqësuesit ligjor të saj ose servisit të autorizuar, kur kjo bëhet me kërkesë apo me miratim me shkrim të palës së tretë/të siguarit.

9. Lëshimi i faturës nga servisi bëhet pas pranimit, pa pretendime të mjetit të riparuar nga pala e tretë/i siguruari.

KREU VIII

DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURA PËR TRAJTIMIN E DËMIT QË RRJEDH NGA KONTRATA E SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË PASAGJERËVE NË TRANSPORTIN PUBLIK

Neni 35

E drejta për dëmshpërblim

Pasagjeri i përfshirë në një aksident ose trashëgimtarët e tij, në rastin kur pasagjeri vdes, ka të drejtë sipas kushteve të kontratës së sigurimit të kërkojë që shoqëria e sigurimit, me të cilën është lidhur kontrata e sigurimit, të paguajë detyrimet që rrjedhin nga kjo kontratë drejtpërdrejtë tek ai.

Dëmshpërblimi për humbjet e pësuar në rast aksidenti përfshin:

1. Dëm pasuror ndaj personit me pasojë vdekje.
2. Dëm pasuror ndaj personit për paaftësi të përhershme për punë.
3. Dëm pasuror ndaj personit për paaftësi të përkohshme për punë dhe trajtimet mjekësore.



Neni 36

Kërkesa për dëmshpërblim

1. Në rast të ndodhjes së aksidentit, i siguruari/pasagjeri i dëmtuar ose trashëgimtarët e tij, në rastin kur pasagjeri vdes, është i detyruar të njoftojë shoqërinë e sigurimit, me të cilën është lidhur kontrata e sigurimit.

2. Njoftimi bëhet brenda 10 ditëve nga data e ndodhjes së aksidentit ose nga momenti që pala e dëmtuar ka pasur mundësi të dërgojë njoftimin.

3. Kërkesa për dëmshpërblim paraqitet me shkrim ose në mënyrë elektronike dhe duhet të tregojë vendin, ditën, orën, shkakun e aksidentit, mjetin e transportit, si dhe itinerarin e udhëtimit.

4. Shoqëria e sigurimit është e detyruar të pranojë dhe të regjistrojë kërkesën për dëmshpërblim.

5. Nëse pronari i një mjeti motorik nuk ka lidhur kontratë për sigurimin e pasagjerëve, sipas dispozitave të ligjit nr. 32/2021 dhe aksidenti ka ndodhur, pasagjeri ose personi përfitues ka të drejtë të kërkojë pagesën e shumës së siguruar nga Fondi i Kompensimit.

Neni 37

Afatet e trajtimit të kërkesës për dëmshpërblim

1. Siguruesi është i detyruar të trajtojë kërkesën për dëmshpërblim, të bëjë verifikimet e nevojshme dhe të njoftojë për masën e dëmshpërblimit apo për refuzimin e kërkesës për dëmshpërblim, brenda 90 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për dëmshpërblim.

2. Për qëllim të pikës 1, të këtij neni, data e marrjes së kërkesës për dëmshpërblim quhet data e depozitimit të kërkesës së bashku me dokumentacionin e plotë shoqërues.

Neni 38

Dokumentacioni i dosjes së dëmit

1. Praktika e dëmit që rrjedh nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik përmban:

a) njoftimi/kërkesa e të siguruarit/pasagjerit të dëmtuar ose përfituesit të tij, në rastin kur pasagjeri vdes, për dëmshpërblim sikurse

përcaktohet në nenin 36 “Kërkesa për dëmshpërblim” të kësaj rregulloreje;

b) certifikata mjekësore e plotësuar dhe e lëshuar nga mjeku që ka bërë vizitën e parë mjekësore të pasagjerit të dëmtuar;

c) raportin mjekësor mbi shkallën e paaftësisë. Raporti i paaftësisë së përhershme për punë, i cili duhet të shprehë në përqindje masën e paaftësisë, duke u bazuar në tabelën “Shkalla e humbjes së paaftësisë së përhershme në punë”;

d) radiografi/skaner/rezonancë magnetike/epikrizë/anamnezë, fletështrimi dhe fletëdalja nga spitali dhe çdo dokument tjetër që ndihmon në vlerësimin e dëmit i lëshuar nga organet kompetente;

e) dokumenti i identifikimi të personit;

f) bileta e udhëtimit/karta ose ndonjë dokument tjetër në origjinal që provon se pala e aksidentuar ka qenë pasagjer;

g) konfirmim me shkrim nga i siguruari se, personi i dëmtuar ka qenë pasagjer i tij. I siguruari është i detyruar të vërtetojë se i aksidentuari ka qenë pasagjer duke udhëtuar me mjetin e tij, pavarësisht nga fakti nëse personi i dëmtuar ishte pajisur me biletë apo udhëtonte pa pagesë për shkak të një statusi ligjor;

h) konfirmimi i mbulimit në sigurim nga shoqëria e sigurimit;

i) raport i policisë rrugore për ngjarjen, nëse ka;

j) certifikata e vdekjes (në rast të vdekjes së pasagjerit);

k) skeda e vdekjes;

l) akti/vendimi për përcaktimin e trashëgimtarëve të të ndjerit;

m) deklarata e pranimi të dëmshpërblimit, e cila do të shërbejë si provë për pranimin e vlerës se dëmshpërblimit nga pala e dëmtuar.

2. Përveç sa është parashikuar pikën 1 të këtij neni, praktika e dëmit mund të përmbajë edhe dokumente të tjera plotësuese që lidhen me trajtimin e dosjes së dëmit.

Neni 39

Përlllogaritja e dëmit me pasoje vdekje

Në rastin e vdekjes së pasagjerit si pasoje e një aksidenti të mbuluar nga sigurimi i detyrueshëm i pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik, shoqëria e sigurimit llogarit vlerën e dëmshpër-



blimit sipas nenit 15, të kësaj rregulloreje brenda kufirit të përcaktuar në nenin 19, pikat 1 dhe 2, germa a), të Ligjit nr. 32/2021.

Neni 40

Përlllogaritja e dëmit ndaj personit me pasojë paaftësinë e përhershme në punë

Në rastin e paaftësisë së përhershme të pasagjerit si pasojë e një aksidenti të mbuluar nga sigurimi i detyrueshëm i pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik, shoqëria e sigurimit llogarit vlerën e dëmshpërblimit sipas nenit 14, të kësaj rregulloreje brenda kufirit të përcaktuar në nenin 19, pikat 1 dhe 2, germa “b”, të ligjit nr. 32/2021.

Neni 41

Përlllogaritja e dëmit ndaj personit me pasojë paaftësinë e përkohshme në punë dhe trajtimet mjekësore

Në rastin e paaftësisë së përhershme të pasagjerit si pasojë e një aksidenti të mbuluar nga sigurimi i detyrueshëm i pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik, shoqëria e sigurimit llogarit vlerën e dëmshpërblimit sipas nenit 16, të kësaj rregulloreje brenda kufirit të përcaktuar në nenin 19, pikat 1 dhe 2, germa “c”, të ligjit nr. 32/2021.

KREU IX

BSHS DHE SHOQËRITË E SIGURIMIT SI ENT KOMPENSUES

Neni 42

Trajtimi dhe pagesa e dëmeve nga Fondi i Kompensimit

1. Praktikrat e dëmeve, objekt i fondit të kompensimit, sipas parashikimeve të nenit 41, të ligjit nr. 32/2021, trajtohen dhe paguhen nga Byroja Shqiptare e Sigurimit.

2. Për ndjekjen e procedurave, trajtimin e dëmeve, kryerjen e pagesave dhe ndjekjen e rimbursimeve nga fondi i kompensimit, BSHS-ja mund të delegojë dhe autorizojë njërin prej anëtarëve të saj.

3. Procedura e trajtimit dhe llogaritjes së dëmshpërblimit sipas pikës 1, të këtij neni, kryhet në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.

4. Praktikrat e dëmeve objekt i fondit të kompensimit raportohen në regjistrin elektronik të dëmeve që administrohet nga Byroja Shqiptare e Sigurimit, sipas procedurave të raportimit të miratuara nga Autoriteti.

Neni 43

Trajtimi dhe pagesa e dëmeve nga shoqëritë e sigurimit si ent kompensues

1. Praktikrat e dëmeve trajtohen dhe paguhen nga Shoqëritë e Sigurimit, si sigurues i drejtpërdrejtë, sipas parashikimeve të nenit 43, të ligjit nr. 32/2021.

2. Procedura e trajtimit dhe llogaritjes së dëmshpërblimit sipas pikës 1, të këtij neni, kryhet në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.

3. Praktikrat e dëmeve objekt i Fondit të Kompensimit raportohen në regjistrin elektronik të dëmeve që administrohet nga Byroja Shqiptare e Sigurimit, sipas procedurave të raportimit të miratuara nga Autoriteti.

Neni 44

Trajtimi i kërkesës për dëmshpërblim nga përdorimi i mjetit motorik me karton jeshil

1. BSHS-ja miraton dhe paguan të gjitha kërkesat për dëmshpërblim, që rrjedhin nga aksidentet e ndodhura në territorin e Republikës së Shqipërisë të shkaktuara nga automjete me targa të huaja të pajisura me karton jeshil, sipas nenit 28, të Ligjit 32/2021.

2. BSHS-ja mund të delegojë shqyrtimin dhe pagesën e një dëmi të tillë anëtarëve të saj ose një korrespondenti të emëruar nga BSHS, të cilët janë të detyruar ta trajtojnë dëmin, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare për sigurimin e detyrueshëm të përgjegjësisë nga përdorimi i mjeteve motorike.



KREU X

DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURA
PËR TRAJTIMIN E DËMIT QË RRJEDH
NGA KONTRATA E SIGURIMIT TË
DETYRUESHËM TË PËRGJEGJËSISË SË
PRONARËVE TË AVIONIT PËR DËMIN
SHKAKTUAR PALËVE TË TRETA

Neni 45

E drejta për dëmshpërblim

Shoqëria e sigurimit dëmshpërblen:

1. Çdo dëm shkaktuar palëve të treta, me pasojë vdekje, dëme trupore, përkeqësim të gjendjes shëndetësore dhe dëmtim apo shkatërrim të pasurisë gjatë fluturimit të avionit;
2. Dëme shkaktuar pasagjerëve me pasojë vdekje, dëme trupore, përkeqësim të gjendjes shëndetësore gjatë përdorimit të avionëve;
3. Dëmtime ose humbje të sendeve personale të pasagjerëve që janë të vendosura në kabinën e avionit;
4. Dëmtime ose humbje të mallrave në transport (*cargo*) dhe të bagazheve që kanë kaluar procesin e regjistrimit.

Neni 46

Kërkesa për dëmshpërblim

1. Në rast të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, pala e dëmtuar është e detyruar të njoftojë siguruesin përgjegjës së pronarit të avionit.
2. Pala e dëmtuar, sipas Kodit Ajror të Republikës së Shqipërisë, humbet të drejtat e tij për dëmshpërblim nëse ai nuk paraqet kërkesë brenda një periudhe prej 3 vjetësh, nga momenti kur ai vihet në dijeni për dëmet dhe për personin përgjegjës të aksidentit.
3. Kërkesa për dëmshpërblim paraqitet me shkrim ose në mënyrë elektronike.
4. Shoqëria e sigurimit është e detyruar të pranojë dhe të regjistrojë kërkesën për dëmshpërblim.
5. Nëse pala e dëmtuar paraqet dokumente false apo mashtron lidhur me ngjarjen e ndodhur, shoqëria e sigurimit ka të drejtë të refuzojë kërkesën për dëmshpërblim.

Neni 47

Afatet e trajtimit të kërkesës për dëmshpërblim

Siguruesi është i detyruar të trajtojë kërkesën për dëmshpërblim, të bëjë verifikimet e nevojshme dhe të njoftojë për masën e dëmshpërblimit apo për refuzimin e kërkesës për dëmshpërblim, brenda 90 ditëve kalendarike, nga data e marrjes së kërkesës për dëmshpërblim.

Neni 48

Dokumentacioni i dosjes së dëmit

1. Praktika e dëmit që rrjedh nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësive së pronarëve të avionëve për dëmin shkaktuar palëve të treta përmban:
 - a) njoftimin/kërkesën e të siguruarit/palës së dëmtuar ose përfituesit të tij, në rastin kur i dëmtuari vdes, për dëmshpërblim sikurse përcaktohet në nenin 45 të kësaj rregulloreje;
 - b) raport të plotë të Autoritetit Kompetent të trafikut ajror për ngjarjen e ndodhur duke dhënë të gjitha hollësitë e nevojshme për ndodhjen e një ngjarje të tillë, si dhe çdo dokumentacion tjetër që vërteton ngjarjen e ndodhur;
 - c) raporti për ngjarjen e ndodhur duhet të përmbajë njoftim për çdo ndjekje penale që ka lidhje me ngjarjen;
 - d) konfirmimi i mbulimit në sigurim nga shoqëria e sigurimit;
 - e) dokumentacioni që vërteton dëmtimin ose humbjen e sendeve personale të pasagjerëve që janë të vendosur në kabinën e avionit si dhe të mallrave në transport (*cargo*) dhe bagazheve;
 - f) Dokumentacioni që vërteton dëmtimin ose shkatërrim të pasurisë gjatë fluturimit të avionit;
 - g) bileta e udhëtimit/karta ose ndonjë dokument tjetër në origjinal që provon se pala e dëmtuar ka qenë pasagjer;
 - h) certifikata mjekësore e plotësuar dhe e lëshuar nga mjeku që ka bërë vizitën e parë mjekësore personit të dëmtuar;
 - i) raport mjekësor mbi shkallën e paaftësisë. Raporti i paaftësisë së përhershme për punë i cili duhet të shprehë në përqindje masën e paaftësisë, duke u bazuar në tabelën “Shkalla e humbjes së paaftësisë së përhershme në punë”;



j) radiografi/skaner/rezonancë magnetike/epikrizë/anamnezë, fletështrimi dhe fletëdalja nga spitali dhe çdo dokument tjetër që ndihmon në vlerësimin e dëmit i lëshuar nga organet kompetente;

k) dokumenti i identifikimi të personit të dëmtuar;

l) certifikata e vdekjes (në rast të vdekjes së personit);

m) skeda e vdekjes;

n) akti/vendimi për përcaktimin e trashëgimtarëve të të ndjerit;

o) deklarata e pranimi të dëmshpërblimit, e cila do të shërbejë si provë për pranimin e vlerës së dëmshpërblimit nga pala e dëmtuar.

2. Përveç sa është parashikuar në pikën 1 të këtij neni, praktika e dëmit mund të përmbajë edhe dokumente të tjera plotësuese që lidhen me trajtimin e dosjes së dëmit.

Neni 49

Përlogaritja e dëmit që rrjedh nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësisë së pronarëve të avionëve për dëmin shkaktuar palëve të treta

1. Përlogaritja e dëmit me pasojë vdekje, dëmtime trupore dhe përkeqësime të gjendjes shëndetësore, do të bëhet sipas parashikimeve të kreut III të kësaj rregulloreje.

2. Përlogaritja e dëmit me pasojë dëmtimin ose shkatërrimin e pasurisë do të bëhet me vlerën e zëvendësimit të pasurisë së dëmtuar ose të shkatërruar, por jo më shumë se limiti i përcaktuar në nenin 53, të ligjit nr. 32/2021.

3. Përlogaritja e dëmtimeve ose humbjeve të sendeve personale të pasagjerëve të vendosura në kabinën e avionit do të jete në masën 1000 SDR.

4. Përlogaritja e dëmtimeve ose humbjeve të mallrave në transport dhe të bagazheve të pranuar (*check-in*) do të jetë 17 SDR për kg, sipas dokumentacionit shoqërues të mallit.

5. Masa e dëmshpërblimit e përlogaritur sipas këtij neni, nuk mund të jetë më e madhe se shuma e sigurimit e përcaktuar në nenin 53, të ligjit nr. 32/2021.

KREU XI

DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURA PËR TRAJTIMIN E DËMIT QË RRJEDH NGA KONTRATA E SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË PËRGJEGJËSISË SË PRONARËVE TË MJETEVE LUNDRUESE PËR DËMIN E SHKAKTUAR PALËVE TË TRETA

Neni 50

E drejta për dëmshpërblim

Shoqëria e sigurimit dëmshpërblen çdo dëm ndaj pronës dhe personit, të shkaktuar ndaj palëve të treta, që rrjedh nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësisë së pronarëve të mjeteve të vogla lundruese për dëmin e shkaktuar palëve të treta.

Neni 51

Kërkesa për dëmshpërblim

1. Në rast të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, pala e dëmtuar është e detyruar të njoftojë siguruesin përgjegjës të pronarit të mjetit lundrues.

2. Kërkesa për dëmshpërblim paraqitet me shkrim ose në mënyrë elektronike.

3. Shoqëria e sigurimit është e detyruar të pranojë dhe të regjistrojë kërkesën për dëmshpërblim.

4. Nëse pala e dëmtuar paraqet dokumente të rreme apo mashtron lidhur me ngjarjen e ndodhur, shoqëria ka të drejtë të refuzojë kërkesën për dëmshpërblim.

Neni 52

Afatet e trajtimit të kërkesës për dëmshpërblim

Siguruesi është i detyruar të trajtojë kërkesën për dëmshpërblim, të bëjë verifikimet e nevojshme dhe të njoftojë për masën e dëmshpërblimit apo për refuzimin e kërkesës për dëmshpërblim, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së kërkesës për dëmshpërblim për dëmet ndaj pronës dhe brenda 90 ditëve kalendarike nga data e plotësimit të dokumentacionit për dëmet ndaj personit.



Neni 53

Dokumentacioni i dosjes së demit

1. Praktika e demit që rrjedh nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësisë së pronarëve të mjeteve lundruese për dëmin shkaktuar palëve të treta përmban:

a) njoftimin/kërkesën e të siguruarit/palës së dëmtuar ose përfituesit të tij, (në rastin kur i dëmtuari vdes), për dëmshpërblim sikurse përcaktohet në nenin 51 të kësaj rregulloreje;

b) dokumentacioni që vërteton regjistrimin e mjetit lundrues në regjistrin e mjeteve lundruese;

c) raport të plotë të Autoritetit Portual/Organit kompetent përkatës për ngjarjen e ndodhur, duke dhënë të gjitha hollësitë e nevojshme për ndodhjen e saj si dhe çdo dokumentacion tjetër që vërteton ngjarjen e ndodhur;

d) raporti për ngjarjen e ndodhur duhet të përmbajë njoftim për çdo ndjekje penale që ka lidhje me ngjarjen;

e) konfirmimi i mbulimit në sigurim nga shoqëria e sigurimit;

f) dokumentacioni që vërteton dëmtimin ose shkatërrimin e pasurisë;

g) certifikata mjekësore e plotësuar dhe e lëshuar nga mjeku që ka bërë vizitën e parë mjekësore të personit të dëmtuar;

h) raport mjekësor mbi shkallën e paaftësisë. Raporti i paaftësisë së përhershme për punë duhet të shprehë në përqindje masën e paaftësisë, duke u bazuar në tabelën “Shkalla e humbjes së paaftësisë së përhershme në punë”;

i) radiografi/skaner/rezonance magnetike/epikrizë/anamnezë, fletështrimi dhe fletëdalja nga spitali, si dhe çdo dokument tjetër që ndihmon në vlerësimin e demit i lëshuar nga organet kompetente;

j) dokumenti i identifikimi të personit të dëmtuar;

k) certifikata e vdekjes (në rast të vdekjes së personit);

l) skeda e vdekjes;

m) akti/vendimi për përcaktimin e trashëgimtarëve të të ndjerit;

n) deklarata e pranimit të dëmshpërblimit, e cila do të shërbejë si provë për pranimin e vlerës së dëmshpërblimit nga pala e dëmtuar.

2. Përveç sa është parashikuar në pikën 1 të këtij neni, praktika e demit mund të përmbajë edhe dokumente të tjera plotësuese që lidhen me trajtimin e tij.

Neni 54

Përlllogaritja e demit që rrjedh nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësisë së pronarëve të mjeteve lundruese për dëmin shkaktuar palëve të treta

1. Përlllogaritja e demit me pasojë vdekje, dëmtime trupore dhe përkeqësim të gjendjes shëndetësore, do të bëhet sipas parashikimeve të kreut III të kësaj rregulloreje.

2. Përlllogaritja e demit me pasojë dëmtimin ose shkatërrimin e pasurisë do të bëhet me vlerën e zëvendësimit të pasurisë së dëmtuar ose të shkatërruar.

3. Masa e dëmshpërblimit e përlllogaritur sipas këtij neni, nuk duhet të jetë më e madhe se shuma e sigurimit e përcaktuar në nenin 51, të ligjit nr. 32/2021.

KREU XII

Neni 55

Kontabilizimi i dëmeve

1. Pagesa e dëmshpërblimit kryhet nga shoqëria e sigurimit përgjegjëse, BSHS-ja ose nga siguroesi i drejtpërdrejtë sipas parashikimeve të nenit 43, të ligjit nr. 32/2021.

2. Shpenzimet për dëme nga shoqëria e sigurimit përgjegjëse klasifikohen të ndara në “shpenzime për dëme të paguara” dhe “shpenzime për trajtim dëmsh”.

3. Në zërin “Shpenzime për dëme të paguara”, regjistrohet vlera e dëmshpërblimit që përfiton personi i dëmtuar/familjarët e tij/palë të treta në rastin e riparimeve të mjeteve të dëmtuara në servis ose klinikave mjekësore, i llogaritur sipas parashikimeve të kësaj rregulloreje.

4. Shpenzimet për dëme të paguara klasifikohen të detajuara sipas llojit të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit si dhe sipas çdo portofoli sigurimi.



5. Në zërin “Shpenzime për trajtim dëmsh”, regjistrohen shpenzimet e tjera që lidhen drejtpërdrejtë me trajtimin e dëmeve. Këtu përfshihen:

- a) shpenzime për vlerësuesit e dëmeve;
- b) konsulenca për trajtim dëmsh;
- c) ekspertiza;
- d) investigime;
- e) shpenzime gjyqësore dhe noteriale;
- f) shpenzime për parandalim dëmsh;
- g) shpenzime për rimorkim, parkim;
- h) kosto të marrjes me qira në rastin kur shoqëria e sigurimit vë në dispozicion të palës së dëmtuar mjet me qira deri në riparimin e mjetit të tij;

i) të tjera shpenzime që lidhen drejtpërdrejtë me trajtim dëmsh.

6. Në rastin e pagesës së dëmshpërblimit nga siguroesi i drejtpërdrejt, ky i fundit i pasqyron shpenzimet e mësipërme sipas standardeve të kontabilitetit, ndërsa shoqëria e sigurimit

përgjegjëse i pasqyron ato menjëherë me plotësimin e dosjes së demit.

7. Regjistrimet e mësipërme duhet të pasqyrohen të rregullta dhe të sinqerta, në përputhje me standardet e kontabilitetit.

KREU XIII

Neni 56

Dispozita kalimtare

Kërkesat për dëmshpërblim me datë aksidenti përpara hyrjes në fuqi ligjit nr. 32/2021 do të trajtohen sipas legjislacionit në fuqi në datën e aksidentit.

Neni 57

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Tabela nr. 1. Koeficientët e llogaritjes së shumës së kapitalizuar.

Mosha	Koe M	Koe F	Mosha	Koe M	Koe F
12	25.55	26.15	47	18.77	20.01
13	25.43	26.05	48	18.47	19.72
14	25.31	25.95	49	18.15	19.42
15	25.19	25.84	50	17.83	19.12
16	25.06	25.74	51	17.50	18.81
17	23.96	24.65	52	17.16	18.48
18	24.80	25.51	53	16.82	18.15
19	24.67	25.40	54	16.46	17.81
20	24.53	25.27	55	16.11	17.46
21	24.38	25.15	56	15.74	17.10
22	24.24	25.02	57	15.37	16.73
23	24.08	24.88	58	14.99	16.35
24	23.93	24.75	59	14.60	15.96
25	23.77	24.60	60	14.20	15.56
26	23.60	24.46	61	13.80	15.15
27	23.43	24.30	62	13.40	14.73
28	23.25	24.14	63	12.98	14.30
29	23.07	23.98	64	12.56	13.86
30	22.88	23.81	65	12.14	13.42
31	22.69	23.64	66	11.72	12.97
32	22.49	23.46	67	11.29	12.51
33	22.29	23.27	68	10.87	12.05
34	22.08	23.08	69	10.44	11.59
35	21.87	22.88	70	10.02	11.12
36	21.65	22.68	71	9.60	10.65
37	21.43	22.47	72	9.18	10.19
38	21.20	22.26	73	8.76	9.72
39	20.96	22.03	74	8.34	9.26
40	20.72	21.81	75	7.93	8.80
41	20.46	21.57	76	7.53	8.35
42	20.20	21.33	77	7.13	7.90
43	19.93	21.08	78	6.74	7.46
44	19.65	20.82	79	6.37	7.04
45	19.37	20.56	80	6.0	6.6
46	19.07	20.29			



KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME

1. Tabela nr. 2. “Shkalla e humbjes së aftësisë së përhershme në punë” është e mbështetur kryesisht në *“European physical and mental disability rating scale for medical purposes”*, të Bashkimit Evropian, si dhe në tabelat analoge të disa vendeve të Ballkanit Perëndimor (Kroaci, Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni). Në këtë tabelë, janë listuar pasojat (sekuelat) e përhershme pasojë e dëmtimeve traumatike nga mjetet motorike dhe në shumicën e rasteve janë të shprehura në përqindje fikse si p.sh. 15%, 40% etj.

Tabela është ndërtuar në përshtatje me topografinë regjionale të sistemeve të organeve të trupit njerëzor është e ndarë në gjashtë pjesë, secila e titulluar me emrin “Artikull”, me numra nga 1 deri në 6. Çdo artikull ndahet në pika dhe nënpika si p.sh. art. 1, pika 1.1, nënpika 1.1.1 e kështu me radhë për secilën pasojë të çdo dëmtimi traumatik.

Vlerësimi mjekësor, në dëmtimet serioze duhet të kryhet në një kohë kur gjendja shëndetësore e të dëmtuarit të ketë arritur një përmirësim mjekësor maksimal, pra rikuperimi të jetë arritur në masën më të mirë të mundshme dhe gjendja invalidizuese e pacientit konsiderohet e palëvizshme. Në këtë kontekst, koeficienti i paaftësisë nuk mund të përcaktohet të paktën para 6 muajve nga data e dëmtimit, përveç rasteve kur palët kanë rënë dakord ndryshe, duke bërë parashikime sa më të sakta për ecurinë e gjendjes shëndetësore dhe përmirësimin e tij maksimal të mundshme; konkluzione për ardhmërinë e të dëmtuarit në bashkëpunim me specialistët e fushave të ndryshme mjekësore.

Vlerësimi mjekësor në përcaktimin e pasojave (residuave) shëndetësore duhet të përshtatë rregullat e mëposhtme:

- të identifikojë të gjitha dëmtimet traumatike, në momentin e traumës sipas përshkrimit të mjekëve të qendrave shëndetësore e spitalore;

- të përcaktojë diagnozën dhe të analizojë ashpërsinë e dëmtimeve dhe pasojat që ato lenë ose do të lenë në jetën e përditshme shoqërore profesionale të të dëmtuarit edhe kur nuk kanë mbaruar procedurat mjekësore të shërimit e rehabilitimit;

- të vlerësojë në përqindje shkallën e zvogëlimit të aktivitetit jetësor të personit të dëmtuar;

- të parashikojë në rastet kur i dëmtuari është në vazhdimësi të procedurave mjekësore paaftësinë pas përfundimit të tyre.

Vlerësimi për përcaktimin e pasojave shëndetësore duhet të bazohet:

1. Në shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumenteve mjekësore që duhen të jenë pjesë e “Dosjes së dëmit”:

- a) *kartelat klinike të trajtimit spitalor të të dëmtuarit* (fotokopje e vulosur dhe firmosur nga përgjegjësi i zyrës së statistikës së institucionit);

- b) *kartela mjekësore personale e shërbimit ambulator të lagjes ku banon i dëmtuari* (fotokopje e vulosur dhe firmosur nga përgjegjësi i zyrës së statistikës së institucionit);

- c) *epikrizat zyrtare të ndryshme apo konsulta mjekësore me firmën dhe vulën personale të specialistit përkatës.*

- d) *raporte paaftësie modular tip A dhe B, ose nga komisionet mediko-legale apo nga KMCAP-i;*

- e) *ro-grafi, skaner, rezonancë magnetike dhe çdo dokument tjetër të lëshuara nga institucionet mjekësore, që mund t'i disponojë i dëmtuari;*

- f) *aktekspertimi zyrtar i mjekësisë ligjore;*

- g) të dhënat e ekzaminimeve plotësuese, ose konsultave specialistike, krahas pasqyrit të aktit duhet t'i bashkëlidhet akti i vlerësimit.

2. PARIMET METODOLOGJIKE TË PËRCAKTIMIT TË KOEFICIENTIT TË PAAFTËSISË

- Caktimi i përqindjeve bëhet në mënyrë të përshtatshme nga 0 deri 100% (totali nuk mund ta tejkalojë 100%-in).

- Në raste të veçanta, kur pasojat e dëmtimeve trupore ndërthuren me pasojat nga një ngjarje të vjetër aksidentale e të dëmtuarit, vlerësimi duhet të bëhet duke zbritur përqindjen e mëhershme të zvogëlimit të aktivitetit jetësor.

- Te pasojat e dëmtimeve të shumëfishta që mund të jenë njëkohësisht të pranishme në regjione të ndryshme të trupit (politraumat) si në kokë, krahë apo gjymtyrë, përqindja e përgjithshme llogaritet duke filluar nga pasoja që ka përqindjen më të lartë, dhe më pas përqindjet vijuese caktohen duke u bazuar në rregullin në formulën e përcaktuar në këtë kapitull.

- Përqindjet e dëmtimit të gishtave mbledhen matematikisht.

- Kur vlera del me presje dhjetore shifra rrumbullakoset me numërorin më lart (p.sh., 10.1 rrumbullakoset 11).



3. METODA PËR LLOGARITJEN E PAAFTËSISË SË PËRHERSHME

Vlerësimi në përqindje do të bëhet sipas artikujve të paraqitur në tabelën 2.

Në rastet e disa dëmtimeve trupore do të bëhet përlllogaritja e humbjes të aftësisë për punë me metodën gjeometrike, duke bërë renditjen nga përqindja më e lartë deri te më e ulëta, sipas formulës më poshtë:

Formula: $1 + 1/2 + 1/4 + 1/8$ etj.

1 Është dëmtimi i parë i plotë që korrespondon me përqindjen më të lartë

$1/2$ Është dëmtimi i dytë që korrespondon me përqindjen e dytë më të lartë (nëse ka dëme të tjera)

$1/4$ Është dëmtimi i tretë që korrespondon me përqindjen e tretë më të lartë (nëse ka dëme të tjera)

$1/8$ Është dëmtimi i katërt që korrespondon me përqindjen e katërt më të lartë (nëse ka dëme të tjera)

Nëse ka dëmtime të tjera vazhdohet formula sipas progresionit në zbritje.

Tabela nr. 2. Shkalla e humbjes së aftësisë për punë

Renditja	Përmbajtja	Niveli i paaftësisë në %
	Art.1 Pasojat e dëmtimeve traumatike të kokës	
Pika 1.1	Sekuelat në SNQ (kranio-cerebrale)	
1.1.1	Lëndime të rënda morfologjike të trurit:	
	a) Gjendje klinike vegetative (dekortikimi trunor)	100%
	b) Tetraplegjia dhe triplegjia me humbje të plotë të veprimeve të pavarura për të kryer aktivitete të nevojave jetësore (varësi e plotë nga të tjerët)	90%
1.1.2	Lëndime të rënda morfologjike të trurit me pasoje të deficiteve motore:	
	a) hemiplegjia complete me afazi	90%
	b) hemiplegji complete pa afazi	75%
	c) paraplegji	70%
	d) monoplegji	40%
Shënim. Për tetraparezën, triparezën, hemiparezën, paraparezën dhe monoparezën caktohet për analogji deri në 2/3 e përqindjes të paaftësisë të caktuar për atë lloje paralize. Vlerësimi të jetë i mbështetur nga specialisti i fushës përkatëse.		
1.1.3	Epilepsitë me humbje të vetëdijes, që nuk mund të kontrollohet nga terapia, me përkeqësim fizik dhe mendor, me atakë disa herë në javë	65%
1.1.4	Epilepsitë me humbje të vetëdijes, që kontrollohen me vështirësi nga terapia, me atakë disa herë në muaj	40%
1.1.5	Epilepsitë me humbje të vetëdijes, që kontrollohen mirë nga terapi	20%
1.1.6	Epilepsitë pa humbje të vetëdijes, me atakë të thjeshta fokale, të diagnostikuara dhe konfirmuara sipas llojit të atakut, shpeshtësisë dhe me efekte anësorë gjatë mjekimit	15%
1.1.7	Lëndim morfologjik i trurit me funksion të dëmtuar cerebral (marramendje, çrregullim të baraspeshës gjatë qëndrimit në këmbë dhe në ecje)	30%
1.1.8	Gjendje pas hematomë e operuar intracerebrale ose subdurale, si dhe kontuzioni cerebral, me çrregullime të vazhdueshme të funksioneve të sistemit nervor vegetativ	30%
1.1.9	Gjendje pas trepanacionit të kafkës, gjendje pas hematomes epidurale të operuar, gjendje pas frakturës së bazës ose të kubesë së kafkës së paoperuar	10%
1.1.10	Sindroma parkinsoniane	
	a) e formës së lehtë	30%
	b) e formës së mesme	50%
	c) e formës së rëndë	70%



1.1.11	Sindroma pseudobulbare	60%
1.1.12	Sindroma cerebelare:	
	a) unilaterale	20%
	b) bilaterale	40%
1.1.13	Meningjiti posttraumatik me kriza të dhimbshme, radikuloalgi, çrregullime të karakterit	20%
1.1.14	Sindroma pas tronditjes së trurit (postcommotio cerberi) të konfirmuar në vijimësi me EEG, ekzaminime otovestibulare dhe oftamologjike	10%

Shënim.

1. Për pikat e mësipërme nga 1.1.1 deri në 1.1.13, koeficienti i paaftësisë në %, nuk mund të jepet pa kaluar të paktën 6 muaj nga momenti i dëmtimit.
2. Te dëmtimet e shumëfishta të trurit, % e paaftësisë nuk mbledhet, por përqindja caktohet vetëm sipas një pike që është më e përshtatshme për të dëmtuarin.
3. Të gjitha format e epilepsisë duhet të jenë të verifikuara në mënyrë spitalore ose ambulatorie me aplikimin e metodave bashkëkohore të diagnostikimit.

Pika 1.2	Pasojat pas dëmtimit të nervave kranialë:	
1.2.1	Dëmtim e n.olfaktorius (i nuhatjes), anosmia	5%
1.2.2	Paralize e n.trigeminus e njëanshme	15%
1.2.3	Paralizë e n.trigeminus e dyanshme	30%
1.2.4	Paralizë e n.facial e njëanshme	20%
1.2.5	Paralizë e n.facial e dyanshme	45%
1.2.6	Paralizë i n.statoakustik me shurdhim të njëanshëm	15%
1.2.7	Paralizë i n.statoakustik me shurdhim të dyanshëm	50%
1.2.8	Dëmtim i n.glosafaringeal me pengesa në gëlltitje	10%
1.2.9	Paralizë e n.hipoglosal	10%

Art. 2	Pasojat e dëmtimeve traumatike të fytyrës	
---------------	--	--

Pika 2.1	Sekuelat në aparatin oftalmologjik	
2.1.1	Humbja e plotë e shikimit në të dy sytë	90%
2.1.2	Humbja e plotë e shikimit në njërin sy	35%
2.1.3	Zvogëlimi i shikimit për çdo të dhjetën e mprehtësisë së të parit	2.5%

Shënim. Në qoftë se në syrin tjetër të të parit është dobësuar mbi 3/10-at, për çdo të dhjetën pasuese të zvogëlimit të shikimit në syrin e dëmtuar, përllogaritet 5%. Vlerësimi do jetë i njëjtë si për myopine dhe për hypermetropine. Për llogaritet me 2.5% për çdo të dhjetën e zvogëlimit të mprehtësisë së shikimit, por nuk mund të tejkalojë 85%.

2.1.4	Diplopia e pariparueshme e dëmtimit të syrit	25%
2.1.5	Lëndimi i kapakëve të syrit	10%
2.1.6	Ptoza (varësia nga kufizimi i fushës vizive)	10%
2.1.7	Lëndimi i aparatit lotor	10%
2.1.8	Afakia e njëanshme	10%
2.1.9	Afakia bilaterale	20%
2.1.10	Pseudofakia e njëanshme	2.5%
2.1.11	Pseudofakia e dyanshme	5%
2.1.12	Midriaza (dhe/ose çrregullimi i akomodimit dhe konvergencës)	5%
2.1.13	Ngushtimi koncentrik i fushës vizive në pjesën e mbetur të syrit:	
	a) deri në 30 shkallë të fushës vizive periferike	20%
	b) deri në 10 shkallë të fushës vizive periferike	15%
	c) deri në 5 shkallë të fushës vizive periferike	10%
2.1.14	Ngushtimi koncentrik i fushës vizive në njërin sy:	
	a) deri në 30 shkallë të fushës vizive periferike	20%
	b) deri në 5 shkallë të fushës vizive periferike	10%
2.1.15	Skotomi qendrore në fushën vizive:	
	a) në njërin sy	25%
	b) në të dy sytë	70%



2.1.16	Kuadrantanopsia sipas tipit	10%
2.1.17	Skotomet paraqëndrore dhe jukstaqendrore me mprehtësi të ruajtur :	
	a) në njërin sy	10%
	b) në të dy sytë	15%
2.1.18	Hemianopsitë (varësisht nga lloji, përfshirja si dhe nga dëmtimi i shikimit në pjesën qendrore të fushës vizive)	50%
Shënim.		
1. Përcaktimi i mprehtësisë së shikimit pas operimit, bëhet jo më përpara se 6 muaj nga data e operacionit.		
2. Nëse ekzistojnë më shumë se një pasojë, pas dëmtimit të syrit, ato nuk mbledhen, por merret në përcaktim vetëm një pasojë, ajo që ka % më të lartë.		
Pika 2.2	Pasojat e dëmtimeve të dëgjimit, hundës dhe zërit (otorinolaringologjia)	
2.2.1	Humbja e plotë e dëgjimit:	
	a) e dyanshme	60%
	b) e njëanshme	15%
2.2.2	Shurdhimi i plotë i njëanshëm me reaksion të shuar kalorik të organit vestibular në atë vesh	20%
2.2.3	Shurdhim i plotë i dyanshëm me reaksion të ruajtur kalorik të organit vestibular në të dyja anët, sipas Fowler-Sabine:	
	a) 20% deri në 30%	5%
	b) 31% deri në 60%	10%
	c) 61% deri në 85%	20%
2.2.4	Shurdhim i plotë i dyanshëm me reaksion të shuar kalorik të organit vestibular në të dyja anët sipas <i>Flowler-Sabine</i> :	
	a) 20% deri në 30%	10%
	b) 31% deri në 60%	20%
	c) 61% deri në 85%	30%
2.2.5	Shurdhim i rëndë i njëanshëm me reaksion të ruajtur kalorik të organit vestibular, me humbje dëgjimi 90-95 decibel	10%
2.2.6	Shurdhim i rëndë i njëanshëm me reaksion të shuar kalorik të organit vestibular, me humbje dëgjimi 90-95 decibel	12%
2.2.7	Tinitus atrium (ushitima në vesh), e izoluar (si pasojë e traumës)	5%
2.2.8	Dëmtim i dyanshëm i organit vestibular, me pengesa objektive:	
	a) dëmtim jo i plotë (me funksion pjesërisht të ruajtur)	10%
	b) dëmtim i plotë (me reaksion të shuar)	25%
2.2.9	Dëmtim i njëanshëm i organit vestibular	
	a) jo i plotë	5%
	b) i plotë	10%
2.2.10	Atakë beninjë paroksizmale të marramendjes	3%
2.2.11	Mbyllja e plotë (pakalueshmëria) e vrimave të hundës	10%
2.2.12	Mbyllja e pjesshme e vrimave të hundës	8%
2.2.13	Mbyllja e plotë (pakalueshmëria) e njëres vrimë të hundës	5%
2.2.14	Afonia	30%
2.2.15	Disfonia në shkallë të rëndë	10%
2.2.16	Disfonia në shkallë të lehtë	5%
2.2.17	Humbja e plotë e laringut me trakeostome të përhershme	50%
2.2.18	Humbja e hundës e pjesshme	15%
2.2.19	Humbja e hundës e plotë	35%
2.2.20	Humbja e nuhatjes	10%
2.2.21	Humbja e pjesshme e llapës së veshit	5%
2.2.22	Humbja e plotë e një llape të veshit	10%
2.2.23	Humbja e plotë e të dyja llapave të veshëve	20%
Pika 2.3	Pasojat e dëmtimeve të lëkurës së fytyrës dhe zgavrës së gojës	



	(stomatologjia)	
2.3.1	Cikatrice (vraje), të shumta, sipërfaqësore, të vijëzuara dhe të hiperpigmentuara që shëmtojnë fytyrën, por pa çrregullime funksionale	15%
2.3.2	Cikatrice hipertrofike (keloide) të shoqëruar me çrregullime funksionale si ngushtimi i gojës, i vrimës së syrit, deformim i hundës	20%
2.3.3	Humbja traumatike e të gjithë dhëmbëve	20%
2.3.4	Humbja e dhëmbit	
	a) humbja e një dhëmbi llogaritet	1%
	b) ndërsa për dhëmbët prerës	1.5%
2.3.5	Dëmtimet maksilo-faciale me hapje të kufizuar të gojës (distanca midis dhëmbëve të sipërm dhe atyre të poshtëm):	
	a) hapje e kufizuar e gojës deri 1 cm	30%
	b) hapje e kufizuar e gojës nga 1–3 cm	15%
	c) hapje e kufizuar e gojës nga 3–4 cm	8%
2.3.6	Pasoja në përtpje dhe kafshim:	
	a) në shkallë të lehtë	6%
	b) në shkallë të mesme	10%
	c) në shkallë të rëndë	15%
2.3.7	Dëmtime deformuese në fytyrë nga frakturat e kockave të fytyrës dhe atyre maksilo-faciale postraumatike me pengesa funksionale:	
	a) shkallë e lehtë	5%
	b) shkallë e mesme	15%
	c) shkallë e rëndë	30%
2.3.8	Amputimi i gjuhës:	
	a) amputimi i 1/3	15%
	b) amputimi i 2/3	25%
	c) amputimi i plotë	35%
Shënim. Prania e cikatricave (varjeve) në pjesët e dukshme të trupit, pa pengesa funksionale, konsiderohet si një çështje estetike-kozmetike. Shëmtimi në të vërtetë përbën një problem të mirëfilltë psikologjik, që bazohet në ndjenjat subjektive e individuale të dëmtuarit (dhimbje shpirtërore), sidomos kur ndodhet në një rreth shoqëror dhe mund të ndihet në vështirësi. Vlerësimi bëhet në përshtatje me moshën, gjininë, profesionin, lokalizimin e dëmtimit, madhësinë e dëmtimit etj.		
Art. 3	Pasoja të dëmtimeve traumatike të kraharorit	
Pika 3.1	Sekulat në aparatit e frymëmarrjes	
3.1.1	Dëmtimet e trakesë:	
	a) Gjendja pas trakeotomisë për shkak të indikacioneve vitale pas dëmtimit	5%
	b) Stenoza e trakesë pas dëmtimit të fytyrës dhe pjesës fillestare të trakesë	10%
3.1.2	Stenoza e trakesë për shkak të bartjes së përgjeshme të kanjules	60%
3.1.3	Dëmtimet e brinjëve:	
	a) thyerja e më së paku dy brinjëve e shëruar me largim ose thyerja e dërrasës së gjoksit e shëruar me largim	5%
	b) thyerja e tri e më shumë brinjëve e shëruar me largim pa zvogëlim të ventilimit të mushkërive të tipit restriktiv	deri 10%
3.1.4	Gjendja pas torakotomisë	deri 10%
Shënim. Për thyerjen e një brinje nuk jepet paaftësi e përhershme.		
3.1.5	Zvogëlimi i funksionit të mushkërive si pasojë e thyerjeve serike të brinjëve apo dëmtimeve penetruese të kafazit të kraharorit, adezioneve postraumatike apo hemotoraksit dhe pneumotoraksit, kapaciteti vital i zvogëluar:	
	a) në shkallë të lehtë, 20 deri 30%	15%
	b) në shkallë të mesme, 31 deri 50%	30%
	c) në shkallë të rëndë, më shumë se 50%	35%
3.1.6	Fistula pas empiemit	15%
3.1.7	Abcesi kronik i mushkërive	25%



3.1.8	Humbja e plotë e një mushkërie:	
	a) E majta	20%
	b) E djathta	35%
3.1.9	Humbja e një lobi të mushkërisë	10%
3.1.10	Humbja e njërit gj:	
	a) deri në moshën 50-vjeçare	10%
	b) mbi moshën 50-vjeçare	5%
3.1.11	Humbja e dy gjinjve:	
	a) deri në moshën 50-vjeçare	25%
	b) mbi moshën 50-vjeçare	10%
Pika 3.2	Sekuelat në aparatin e zemrës dhe enëve të gjakut	
3.2.1	Dëmtimet penetruese të zemrës:	
	a) zemra me EKG normale	30%
	b) zemra me EKG të ndryshuar	45%
3.2.2	Ruptura e aortës së operuar:	
	a) me protezë	10%
	b) operimi endoskopik me graft	20%
3.2.3	Rikonstruksion i arterieve periferike:	
	a) me venë	5%
	b) me protezë	10%
3.2.4	Dëmtim i venave dhe sistemit limfatik të shoqëruara me ënjtje të këmbëve, dermanit hipostatik dhe ulceracione	10%
3.2.5	Dëmtim i venave dhe i sistemit limfatik të shoqëruar me ndjenjë të këmbëve të rënuara dhe ënjtje	10%
Art. 4	Pasojat e dëmtimeve traumatike të barkut	
Pika 4.1	Sekuelat në aparatin e tretjes	
4.1.1	Çrregullimet e gjëlltjes:	
	a) në shkallë të lehtë (e verifikuar me Rg dhe endoskopi)	5%
	b) në shkallë të rëndë (gjëlltje vetëm e ushqimit të qullët)	15%
	c) pamundësi e plotë e gjëlltjes (sonda ose gastrostoma e detyrueshme)	70%
4.1.2	Ngushtim i ezofagut:	
	a) në shkallë të lehtë (e verifikuar me endoskop)	5%
	b) në shkallë të mesme (e verifikuar me endoskop)	10%
	c) në shkallë të rëndë (e verifikuar me endoskop)	20%
4.1.3	Laparatomia dhe hernia:	
	a) vrraja operatore pas laparatomisë, ose hernia post traumatike e murit të barkut	10%
	b) hernia diafragmave recidivuese pas trajtimit kirurgjikal të hennisë diafragmave posttraumatike	30%
4.1.4	Dëmtimi i stomakut:	
	a) me qepje	15%
	b) me reseksion	20%
4.1.5	Dëmtimet e zorrëve:	
	a) Me qepje	5%
	b) Me rezeksion (varësisht nga shkalla e rezeksionit dhe pasojave funksional	10%
4.1.6	Dëmtimet e mëlçisë:	
	a) me qepje	5%
	b) me rezeksion 1-3 segmente	10%
	c) me rezeksion mbi 3 segmente	15%
	d) hepatektomia e majtë ose e djathtë	25%
	e) transplantimi i mëlçisë	50%
4.1.7	Dëmtimi i pankreasit:	
	a) pankreatektomia distale	15%



	b) reseksioni i kokës së pankreasit	30%
4.1.8	Humbja e shpretkës:	
	a) deri në moshën 20-vjeçare	20%
	b) mbi moshën 20-vjeçare	15%
4.1.9	Anusi i kundërnatyrshëm (<i>anus praeter naturalis</i>) i përhershëm:	
	a) ileostoma	35%
	b) kolostoma	30%
4.1.10	Fistula sterkorale (<i>stercoralis</i>)	25%
4.1.11	Mospërmbajtja e fekaleve (<i>incontinentia alvi</i>):	
	a) e pjesshme	15%
	b) e plotë	45%
Pika 4.2	Sekuelat në aparatit urinar	
4.2.1	Humbja e një veshke me funksionim normal të veshkës tjetër	40%
4.2.2	Humbja e një veshke me dëmtim funksional të veshkës tjetër:	
	a) në shkallë të lehtë deri në 30% të dëmtimit të funksionimit	35%
	b) në shkallë të mesme deri në 50% të dëmtimit të funksionimit	50%
	c) në shkallë të lartë mbi 50% të dëmtimit të funksionimit	70%
4.2.3	Dëmtimi (rupture e pjesshme) e veshkës me qepje	10%
4.2.4	Çrregullim i lëshimit të urinës për shkak të dëmtimit të uretres të shkallëzuar sipas Charriere:	
	a) në shkallë të lehtë nën 18CH	5%
	b) në shkallë të mesme nën 14CH	15%
	c) në shkallë të rëndë nën 6 CH	30%
4.2.5	Dëmtimi i fshikëzës urinare me kapacitet të zvogëluar për çdo 1/3 e kapacitetit të zvogëluar	10%
4.2.6	Mospërmbajtja (<i>inkontinencia</i>) e plotë urinare:	
	a) te meshkujt	40%
	b) te femrat	50%
4.2.7	Fistula urinare:	
	a) uretrale	20%
	b) perineale dhe vaginale	30%
Pika 4.3	Sekulat në aparatit riprodhues	
4.3.1	Humbja e një testisi deri në moshën 60-vjeçare	15%
4.3.2	Humbja e një testisi mbi në moshën 60-vjeçare	5%
4.3.3	Humbja e dy testeve deri në moshën 60-vjeçare	40%
4.3.4	Humbja e dy testiseve mbi moshën 60-vjeçare	15%
4.3.5	Humbja e penisit deri në moshën 60-vjeçare	50%
4.3.6	Humbja e penisit mbi moshën 60-vjeçare	30%
4.3.7	Humbja e mitrës (<i>histerektomia</i>):	
	a) në periudhën riprodutive	35%
	b) pas menopauzës	10%
4.3.8	Humbja e tubit uterin dhe vezores në periudhën riprodutive	
	a) e njëanshme	10%
	b) e dyanshme	20%
4.3.9	Dëmtimet e vulvës dhe vaginës që pamundësojnë bashkëjetesën deri në moshën 60-vjeçare	40%
4.3.10	Dëmtimet e vulvës dhe vaginës që pamundësojnë bashkëjetesën mbi moshën 60-vjeçare	15%
4.3.11	Dëmtimet e nënës me fëmijë në bark bëhen duke vlerësuar vetëm dëmtimet e nënës nëse ka të tilla.	
Art. 5	Pasojat e dëmtimeve traumatike të sistemi osteo-artikular	



Pika 5.1	Sekuelat në gjymtyrët e sipërme	Anesia dominant e	Jodominant e
5.1.1	Amputimet (gjymtyrët e sipërme)		
5.1.1.1	Humbja e krahut në artikulacionin e shpatullës	65%	60%
5.1.1.2	Humbja e krahut mbi 2/3-tën	60%	55%
5.1.1.3	Humbja e krahut nën 1/3-tën	55%	50%
5.1.1.4	Humbja e parakrahut	50%	45%
5.1.1.5	Humbja e të dy krahëve në artikulacionin e shpatullave	90%	
5.1.1.6	Humbja e të dy krahëve mbi nivelin e bërrylit	80%	
5.1.1.7	Humbja e të dy parakrahëve	75%	
5.1.2	Krahu dhe nyja e krahut		
5.1.2.1	Ankiloza		
	a) në pozitë të pafavorshme funksionale	35%	30%
	b) në pozitë të favorshme funksionale	30%	25%
5.1.2.2	Kontraktura e nyjës së krahut pas lëndimit të strukturave kockore-ligamentoze:		
	a) në shkallë të lehtë (deri në 1/3)	5%	4%
	b) në shkallë të mesme (deri në 2/3)	12%	10%
	c) në shkallë të rëndë (mbi 2/3)	20%	18%
5.1.2.3	Arthroza posttraumatike e nyjës së krahut me kufizim të lëvizjes:		
	a) në shkallë të lehtë (deri 1/3)	10%	8%
	b) në shkallë të mesme (deri 2/3)	15%	13%
	c) në shkallë të rëndë (mbi 2/3)	25%	23%
5.1.2.4	Instabilitet i nyjës së krahut pas luksacionit	15%	10%
5.1.2.5	Ngjitje jo e rregullt e klavikulës	5%	5%
5.1.2.6	Pseudoarthroza e klavikulës	10%	10%
5.1.2.7	Pseudoarthroza e humerusit	25%	20%
5.1.2.8	Osteomieliti kronik i humerusit	25%	20%
5.1.2.9	Osteomieliti kronik i klavikulës	10%	10%
5.1.2.10	Endoproteza e nyjës së krahut	20%	15%
5.1.2.11	Luksacion i mbetur i nyjës akromioklavikulare	10%	10%
5.1.2.12	Luksacion i mbetur i nyjës sternoklavikulare	5%	5%
5.1.3	Bërryli dhe parakrahu		
5.1.3.1	Ankiloza:		
	a) në pozitë të pafavorshme funksionale	30%	25%
	b) në pozitë të favorshme funksionale	25%	20%
5.1.3.2	Kontraktura e nyjës së bërrylit pas lëndimit të strukturave kockore-ligamentoze:		
	a) në shkallë të lehtë (deri 1/3)	5%	4%
	b) në shkallë të mesme (deri 2/3)	10%	8%
	c) në shkallë të rëndë (mbi 2/3)	20%	18%
5.1.3.3	Arthroza posttraumatike e nyjës së bërrylit me kufizim të lëvizjes së tyre:		
	a) në shkallë të lehtë (deri 1/3)	10%	8%
	b) në shkallë të mesme (deri 2/3)	15%	13%
	c) në shkallë të rëndë (mbi 2/3)	25%	23%
5.1.3.4	Rotacioni i zvogëlimit të parakrahut (pro/supinacion):		
	a) në shkallë të lehtë	5%	4%
	b) në shkallë të mesme	8%	7%
	c) në shkallë të rëndë	13%	11%
5.1.3.5	Osteomieliti kronik i njëres kockë të parakrahut	12%	12%
5.1.3.6	Osteomieliti kronik i të dyja kockave të parakrahut	15%	15%



5.1.3.7	Pseudoartroza e radiusit ose ulnes	15%	15%
5.1.3.8	Pseudoartroza e dy kockave të parakrahut	25%	20%
5.1.3.9	Endoproteza e nyjës së bërrylit	20%	18%
5.1.3.10	Instabiliteti i nyjës së bërrylit nga raptura e ligamenteve kolaterale	13%	10%
5.1.4	Kyçi i dorës		
5.1.4.1	Ankiloza:		
	a) në ekstension	15%	10%
	b) në të njëjtën rrafsh me parakrahun	20%	15%
	c) në fleksion	30%	20%
5.1.4.2	Kontraktura të nyjës së kyçit të dorës:		
	a) në shkallë të lehtë	6%	4%
	b) në shkallë të mesme	10%	8%
	c) në shkallë të rëndë	20%	15%
5.1.4.3	Artroza postraumatike e kyçit të dorës me kufizim të lëvizjes së artikulationit:		
	a) në shkallë të lehtë	10%	8%
	b) në shkallë të mesme	15%	13%
	c) në shkallë të rëndë	25%	23%
5.1.4.4	Endoproteza e kockës skafoide	8%	7%
5.1.4.5	Pseudoartroza e kockës skafoide	10%	8%
5.1.4.6	Endoproteza e kyçit të dorës	22%	20%
5.1.4.7	Ngjitje jo e rregullt pas thyerjes së kockës I MC	4%	4%
5.1.4.8	Ngjitje jo e rregullt e kockës II, III, IV dhe V të MC	3%	3%
5.1.5	Shuplaka e dorës		
5.1.5.1	Amputimi i shuplakës së dorës	50%	45%
5.1.5.2	Amputimi i të dyja shuplakave	75%	
5.1.5.3	Amputimi i gishtit të madh të dorës:		
	a) me humbje të MC+PP+DP	30%	25%
	b) me humbje të PP+DP	20%	18%
	c) me humbje të DP	10%	9%
5.1.5.4	Amputim i gishtit II deri V:		
	a) gishti tregues	12%	10%
	b) gishti i mesëm dhe i vogël	8%	6%
	c) gishti i unazës	4%	3%
Shënim. Për humbjen e një falange nga gishti II-V, caktohet 1/3 e përqindjes së humbjes së gishtit.			
5.1.5.5	Amputim i të gjithë gishtave të dorës:		
	a) së njëjës dorë	42%	40%
	b) të dyja duarve	70%	
5.1.5.6	Ankiloza e gishtit të madh në pozitë të favorshme:		
	a) në të dyja nyjat e gishtit	15%	13%
	b) në nyjën MCP (metakarpofalangeal)	8%	7%
	c) në nyjën IP (interfalangeale)	4%	3%
5.1.5.7	Ankiloza e të dyja nyjave të gishtit të madh në pozitë jofunksionale (fleksion ose ekstension i plotë)	18%	15%
5.1.5.8	Ankiloza e gishtave të tjerë në pozitë të favorshme:		
	a) gishti tregues	6%	5%
	b) gishti i mesëm	5%	4%
	c) gishti i unazës	4%	3%
	d) gishti i vogël	4%	3%
5.1.5.9	Ankiloza e gishtave të tjerë në pozitë jofunksionale:		
	a) gishti tregues	8%	7%
	b) gishti i mesëm	7%	6%
	c) gishti i unazës	6%	5%



	d) gishti i vogël	6%	5%
5.1.5.10	Lëvizshmëria e zvogëluar në një nyjë të gishtit tregues:		
	a) në shkallë të lehtë	2.5%	2%
	b) në shkallë të rëndë	3%	2.5%
5.1.5.11	Lëvizshmëria e zvogëluar në një nyjë të gishtit tregues:		
	a) në shkallë të lehtë	2%	1.5%
	b) në shkallë të rëndë	3%	2.5%
5.1.5.12	Lëvizshmëria e zvogëluar në një nyjë të gishtave të tjerë:		
	a) në shkallë të lehtë	1%	1%
	b) në shkallë të rëndë	1.5%	1.5%
5.2	Gjymtyrët e poshtme		
5.2.1	Amputimet		
5.2.1.1	Humbja e të dyja kofshëve:		
	a) pa mundësi trajtimi protetik	90%	
	b) me mundësi trajtimi protetik	70%	
5.2.1.2	Eksartikulimi i këmbës në kyçin e kofshës	65%	
5.2.1.3	Humbja e kofshës në 1/3 e sipërme, mbetja e papërshtatshme për protezë	60%	
5.2.1.4	Humbja e kofshës në 1/3 e sipërme, mbetja e përshtatshme për protezë	50%	
5.2.1.5	Ekzartikulimi i gjurit	40%	
5.2.1.6	Humbja e dy nëngjunjëve (kërcinjtë), mbetja e papërshtatshme për protezë	65%	
5.2.1.7	Humbja e dy nëngjunjëve (kërcinjtë), mbetja e përshtatshme për protezë	60%	
5.2.1.8	Humbja e nëngjurit (kërcirit) cungu i papërshtatshëm për protezë	45%	
5.2.1.9	Humbja e nëngjurit (kërcirit) cungu i përshtatshëm për protezë	40%	
5.2.1.10	Humbja e të dy kërcinjve, cungu i përshtatshëm për protezë	60%	
5.2.1.11	Humbja e të dy kërcinjve, cungu i papërshtatshëm për protezë	75%	
5.2.1.12	Humbja e të dyja shputave	55%	
5.2.1.13	Humbja e një shpute	35%	
5.2.1.14	Humbja e një shpute në vijën Chopari	25%	
5.2.1.15	Humbja e shputës në vijën Lisfranc	30%	
5.2.1.16	Amputimi transmetatarsal	25%	
5.2.1.17	Humbja e kockës I dhe V të metatarsale	5%	
5.2.1.18	Humbja e kockës së II, III dhe IV-të metatarzale, (për secilin)	3%	
5.2.1.19	Humbja e të gjithë gishtave të shputës së një këmbë	20%	
5.2.1.20	Humbja e gishtit të madh të shputës:		
	a)humbja nga nyja distale e gishtit	5%	
	b)humbja e plotë e gishtit	10%	
5.2.1.21	Humbja e plotë e gishtave II-V, në shputë, për secilin	2.5%	
5.2.1.22	Humbja e pjesëshme e gishtave II-V, në shputë, për secilin	1%	
Shënim. Shtangimi i nyjeve intrafalangeale të gishtit II-V, në pozitë të shtrirë ose lëvizshmëria e zvogëluar e këtyre nyjeve nuk paraqet invaliditet.			
5.2.2	Kofsha		
5.2.2.1	Shtangimi i plotë i kyçit të kofshës në pozitë funksionale të volitshme	30%	
5.2.2.2	Shtangimi i plotë i kyçit të kofshës në pozitë funksionale të papërshtatshme	40%	
5.2.2.3	Shtangim i plotë i të dyja kyçeve të kofshës	70%	
5.2.2.4	Nxjerrja traumatike e vjetër e pareponuar e kyçit të kofshës	40%	
5.2.2.5	Pseudoartroza e qafës së femurit me shkurtim	45%	
5.2.2.6	Artroza deformuese postraumatike e kyçit të kofshës pas thyerjes me lëvizje të zvogëluar të kyçit me verifikim të radiografive apo metodave dhe mjeteve të tjera bashkëkohore, krahasuar me të shëndoshin:		
	a) në shkallë lehtë, vogëlim deri në 1/3 e lëvizshmërisë së nyjës, deri	15%	
	b) në shkallë të mesme, zvogëlim deri në 2/3 e lëvizshmërisë së nyjës	25%	
	c) në shkallë të rëndë, zvogëlim mbi 2/3 e lëvizshmërisë së nyjës	5%	



5.2.2.7	Endoproteza e kyçit të kofshës	30%
5.2.2.8	Lëvizshmëri e zvogëluar e kyçit të kofshës krahasuar me të shëndoshin:	
	a) në shkallët lehtë, zvogëlim deri në 1/3 e lëvizshmërisë së nyjës, deri	10%
	b) në shkallë të mesme, zvogëlim deri në 2/3 e lëvizshmërisë së nyjës	15%
	c) në shkallë të rëndë, zvogëlim mbi 2/3 e lëvizshmërisë së nyjës	25%
5.2.2.9	Pseudoartoza e femurit	45%
5.2.2.10	Shërim jo i drejtë i thyerjes së femurit në këndin:	
	a) 10-20 shkallë,	deri në 10%
	b) mbi 20 shkallë	15%
5.2.2.11	Osteomioliti kronik me fistulë	10%
5.2.2.12	Shenjat e mëdha dhe të thella në muskujt e kofshës dhe nëngjurit, si dhe hernitë traumatike të muskujve të kofshës dhe nëngjurit pa çrregullim të funksionit të nyjës,	deri në 10%
5.2.2.13	Ndryshimi cirkulator, pas dëmtimit të enëve të mëdha të gjakut në këmbë:	
	a) të nëngjurit	deri në 10%
	b) kofshës	deri në 20%
5.2.2.14	Shkurtimi i këmbës si pasojë e thyerjes:	
	a) 2–4 cm	deri në 10%
	b) 4–6 cm	deri në 15%
	c) mbi 6 cm	20%
5.2.3	Gjuri dhe kërciri	
5.2.3.1	Shtangim i gjurit:	
	a) në pozitë të përgjithshme funksionale (deri në 10 shkallë) të fleksionit	25%
	b) në pozitë të papërshtatshme funksionale	35%
5.2.3.2	Artroza deformuese e gjurit pas lëndimit të pjesëve nyjore me lëvizshmëri të zvogëluar, me verifikim të radiografive apo metodave dhe mjeteve bashkëkohore, të krahasuar me të shëndoshin:	
	a) në shkallët lehtë, zvogëlim deri në 1/3 e lëvizjes (91°-135°)	deri 15%
	b) në shkallë të mesme, zvogëlim deri në 2/3 e lëvizjes (46°-90°)	20%
	c) në shkallë të rëndë, zvogëlim mbi 2/3 e lëvizjes (0°-45°)	30%
5.2.3.3	Lëvizshmëri e zvogëluar e nyjës së gjurit, krahasuar me të shëndoshin:	
	a) në shkallët lehtë, zvogëlim deri në 1/3 e lëvizjes (91°-135°),	deri 10%
	b) në shkallë të mesme, zvogëlim deri në 2/3 e lëvizjes (46°-90°),	15%
	c) në shkallë të rëndë, zvogëlim mbi 2/3 e lëvizjes (0°-45°),	20%
5.2.3.4	Fleksion i zvogëluar i gjurit për më pak se 15 shkallë	5%
5.2.3.5	Lëshim i gjurit pas lëndimit të kapsulës dhe aparatit ligamentoz, krahasuar me të shëndoshin:	
	a) tolerim në një drejtim	deri 10%
	b) tolerim në dy drejtime	15%
	c) tolerim i plotë (bartje e përhershme e aparatit ortopedik)	40%
5.2.3.6	Endoproteza e gjurit	25%
5.2.3.7	Dëmtimi i meniskusit me pengesa, përsëritëse ose gjendja pas largimit operativ të meniskut	5%
5.2.3.8	Trup artikular i lirë në nyjë i krijuar pas dëmtimit	5%
5.2.3.9	Pengesa funksionale pas largimit të patellës (kupës së gjurit):	
	a) patella e larguar pjesërisht	5%
	b) patella e larguar tërësisht	15%
5.2.3.10	Sinoviti traumatik i përsëritur i gjurit dhe hemartroza / ose condromalicia traumatike e patelës	10%
5.2.3.11	Pseudoartroza e tibies	30%
5.2.3.12	Shërim jo i plotë i thyerjes së nëngjurit me deformim valgus, varus ose recurvatus, krahasuar me të shëndoshin:	



	a) prej 5–15 shkallë	10%
	b) mbi 15 shkallë	15%
5.2.3.13	Osteomielit kronik i tibies	15%
5.2.3.14	Osteomielit kronik o fibules ose pateles	10%
5.2.3.15	Gjendje pas ruptures së tendinit të <i>Achilit</i>	10%
5.2.4	Kyçi i këmbës dhe shputa	
5.2.4.1	Ankiloze e artikulacionit të këmbës:	
	a) në pozitë funksionale	15%
	b) në pozitë jofunksionale (fleksioni plantar mbi 10 shkallë)	20%
5.2.4.2	Lëvizshmëri e zvogëluar (kontraktura) e artikulacionit të këmbës:	
	a) në shkallët lehtë, zvogëlim deri në 1/3 e lëvizshmërisë së nyjës	5%
	b) në shkallë të mesme, zvogëlim deri në 2/3 e lëvizshmërisë së nyjës	10%
	c) në shkallë të rëndë, zvogëlim mbi 2/3 e lëvizshmërisë së nyjës	15%
5.2.4.3	Artroza posttraumatike e artikulacionit të këmbës me kufizim lëvizjeve:	
	a) në shkallë të lehtë	10%
	b) në shkallë të mesme	15%
	c) në shkallë të rëndë	25%
5.2.4.4	Endoproteza e artikulacionit të këmbës	25%
5.2.4.5	Instabilitet i artikulacionit pas dëmtimit ligamentoz (MR-CT-UZ)	10%
5.2.4.6	Ankiloza:	
	a) në nyjën <i>Chopart</i>	4%
	b) në nyjën <i>Lisfranc</i>	4%
5.2.4.7	Ankiloza:	
	a) e nyjës së MTP të gishtit të madh	7%
	b) e nyjës IP të gishtit të madh	4%
	c) e të dyja nyjave në pozitë flektore	10%
	d) e gishtit II-V në pozitë ekstenzore	1%
	e) e gishtit II-V në pozitë flektore	1,5%
5.2.4.8	Zgjerim traumatik i morsetës maleolare, nga dëmtimi kockor-ligamentoz	15%
5.2.4.9	Deformimi posttraumatik i shputës, pes excavatus, pes planovalgus, pes equinus, pes varus:	
	a) në shkallë të lehtë	deri në 10%
	b) në shkallë të rëndë	20%
5.2.4.10	Deformimi i kalkaneusit pas thyerjes shtypëse	15%
5.2.4.11	Deformimi i talusit pas thyerjes pa artrozë deformuese, të nyjës talokrurale	20%
5.2.4.12	Thyerjet e izoluara të kockave të tarsale pa ndonjë deformim të madh	5%
5.2.4.13	Deformimi i një ashti metatarsal pas thyerjes për secilin (por jo më shumë se 10%)	3%
5.2.4.14	Deformimi më i madh i metatarsusit pas thyerjes së kockës metatarzale	deri në 10%
5.2.4.15	Shtangim i plotë i nyjës distale të gishtit të madh	2,5%
5.2.4.16	Shtangim i plotë i nyjës proksimale të gishtit të madh ose të nyjave	5%
5.2.4.17	Shtangim i nyjës proksimale të gishtërinye II-V, për secilin gisht	1%
5.2.4.18	Deformimi ose shtangimi i gishtit II-V, në këmbë të mbledhur (<i>digitus flexus</i>), për secilin gisht	1,5%
5.2.4.19	Defekte të mëdha në thembër ose taban pas lëndimit të pjesëve të buta:	
	a) sipërfaqja deri 1/2 e tabanit	deri në 10%
	b) sipërfaqja mbi 1/2 e tabanit	deri në 15%
Shënim. Në rastet e vlerësimit të konsolidimit të frakturave, ekzaminimi duhet kryhet jo më parë se 6 muaj pas aksidentit.		
Pika 5.3	Pasojat pas dëmtimit të nervave periferike të gjymtyrëve:	
5.3.1	Paralizë e pleksusit brakial	50%
5.3.2	Paralizë e pjesshme e pleksusit brakial (Erb ose Klumpke)	35%



5.3.3	Paralizë e n.aksilar	15%
5.3.4	Paralizë e n.radial	25%
5.3.5	Paralizë e n.median	20%
5.3.6	Paralizë e n.ulnar	15%
Shënim. Përqindjet e mësipërme i referohen dorës dominante, për dorën jodominante përqindja ulet me 5%.		
5.3.7	Paralizë e n.femoral e njëanshme	15%
5.3.8	Paralizë e n.femoral e dyanshme	25%
5.3.9	Paralizë e n.tibial e njëanshme	20%
5.3.10	Paralizë e n.tibial e dyanshme	30%
5.3.11	Paralizë e n.peroneus e njëanshme	20%
5.3.12	Paralizë e n.peroneus e dyanshme	30%
5.3.13	Paralizë e n.gluteal e njëanshme	10%
5.3.14	Paralizë e n.gluteal e dyanshme	15%
5.3.15	Paralizë e n.ishiatik i njëanshëm	30%
5.3.16	Paralizë e n.ishiatik i dyanshëm	40%
Shënim. Për paze të nervave caktohet maksimalisht deri në ½ e invaliditetit të caktuar për paralizë të atij nervi.		
Pika 5.4 Sekuelat në shtyllën kurrizore (medula dhe vertebrat)		
5.4.1	Pasojat (sekuelat) motorike dhe sensomotore me origjinë medulare:	
5.4.1.1	Tetraplegji e plotë nga vertebra C2 deri te C6	100%
5.4.1.2	Tetraplegji e plotë nën vertebrën C6	95%
5.4.1.3	Paralizë e plotë e gjymtyrëve të poshtëm (paraplegji) me humbje të kontrollit të sfinkterëve	75%
5.4.1.4	Paralizë e plotë e gjymtyrëve të poshtëm(paraplegji) me kontroll të ruajtur të sfinkterëve	60%
5.4.1.5	Tetrapareza, pacienti lëviz me ndihmën e të tjerëve	70%
5.4.1.6	Tetrapareza, pacienti lëviz pa ndihmën e të tjerëve	30%
5.4.1.7	Tripareza, pacienti lëviz me ndihmën e të tjerëve	60%
5.4.1.8	Tripareza, pacienti lëviz pa ndihmën e të tjerëve	25%
5.4.1.9	Parapareza, pacienti lëviz me ndihmën e të tjerëve	45%
5.4.1.10	Parapareza, pacienti lëviz pa ndihmën e të tjerëve	15%
5.4.2	Pasojat e dëmtimeve të vertebrave	
5.4.2.1	Zvogëlim i lëvizshmërisë dhe dhimbjet pas dëmtimit të indeve të buta të qafës, pa instabilitet	3%
5.4.2.2	Zvogëlim i lëvizshmërisë pas thyerjes së vertebrave të qafës (pa dëmtim të medules):	
	a) në shkallë të lehtë	5%
	b) shkallë të mesme	10%
	c) shkallë të rëndë	20%
5.4.2.3	Lëvizshmëri e zvogëluar e shtyllës kurrizore pas frakturave të vertebrave të regjionit torakal:	
	a) në shkallë të ultë	5%
	b) shkallë të mesme	7%
	c) shkallë të rëndë	10%
5.4.2.4	Lëvizshmëri e zvogëluar e shtyllës kurrizore pas frakturave të vertebrave të regjionit lumbar:	
	a) në shkallë të ulur	5%
	b) shkallë të mesme	10%
	c) shkallë të rëndë	25%
5.4.2.5	Thyerje e vazhdueshme (serike) e tri ose më shumë zgjatimeve spinoze,	5%
5.4.2.6	Thyerje e vazhdueshme (serike) e tri ose më shumë zgjatimeve transverse	8%
5.4.2.7	Koksigodinia posttraumatike	5%
Pika 5.5 Kockat e legenit (pelvisi)		
5.5.1	Thyerjet e shumëfishta të kockave të legenit me deformim të rëndë ose me	30%



	denivelim të njave sakro-iliake dhe pubike	
5.5.2	Simfizioliza me largim horizontal dhe/ose vertikal:	
	a) me madhësi 1 cm	10%
	b) me madhësi 2 cm	15%
	c) me madhësi mbi 2 cm	25%
5.5.3	Thyerja e njërës kockë të iltiumit me largim	10%
5.5.4	Thyerja e të dyja kockave të iltiumit me largim	15%
5.5.5	Thyerja e kockës pubike ose ischiadike me largim	10%
5.5.6	Thyerje e dy kockave pubike ose ischiadike me largim	20%
5.5.7	Thyerja e kockës sakrale me largim	10%
5.5.8	Thyerja e kockës kokcigeale:	
	a) me largim ose me fragment të thyer i larguar kirurgjikisht	5%
	b) e larguar në mënyrë operative	10%
Shënim. Thyerjet e kockave të legenit (pelvikut) që janë ngjitur pa largim e pa pengesa funksionale objektive, nuk caktohet invaliditet.		
Art. 6	Pasojat traumatike të lëkurës nga djegiet dhe flokëve	
6.1	Vrajat (cikatricet) e thella në trup pas djegieve apo defekteve pa pengim të motilitetit:	
	a) deri në 10% të sipërfaqes trupore	deri në 5%
	b) deri në 20% të sipërfaqes trupore	deri në 10%
	c) mbi 20% të sipërfaqes trupore	deri në 15%
6.2	Vrajat (cikatricet) e thella në trup pas djegieve apo defekteve me pengesa të motilitetit:	
	a) deri në 10% të sipërfaqes trupore	deri në 10%
	b) deri në 20% të sipërfaqes trupore	deri në 20%
	c) mbi 20% të sipërfaqes trupore	deri në 30%
6.3	Humbja e flokëve të meshkujt:	
	a) 1/3 e sipërfaqes së flokëve	5%
	b) 1/2 sipërfaqes së flokëve	10%
	c) krejt flokët	30%
6.4	Humbja e flokëve të femrat:	
	a) 1/3 e sipërfaqes së flokëve	10%
	b) 1/2 sipërfaqes së flokëve	20%
	c) krejt flokët	40%

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 176 lekë